

FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI I PRISHTINËS



EduForum
REVISTA PËR MËSIMDHËNËS

01/2025

www.edukimi.uni-pr.edu

EduForum

REVISTA PËR MËSIMDHËNËS

Botuar nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

Për botuesin: Prof. Asoc. Blerim Saqipi, Dekan

Nr: 01/2025

Kontakti: edukimi@uni-pr.edu

Kontribuesit redaktorial të këtij numri:

Prof. Asoc. Majlinda Gjelaç

Prof. Asst. Blerta Perolli Shehu

Prof. Asoc. Vlora Sylaj

Prof. Asoc. Teuta Danuza

Prof. Asst. Albulena Metaj Macula

Prof. Asst. Fjolla Kaçaniku

Lekturimi: Prof. Asst. Muhamet Peci

Përgatitja teknike: Vlerë Jashari, PhD.

Njihuni me revistën EduForum si nismë për zhvillimin e debatit akademik në arsimin parauniversitar

Nisma për themelimin e 'EduForum' në Fakultetin e Edukimit, si një revistë profesionale për komunitetin arsimor në Kosovë, ka dalë si rrjedhojë e nevojës për të plotësuar një zbrastësirë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e debatit në sektorin e sistemit shkollor në Kosovë. Ky debat nuk mund të bëhet vetëm në formën e takimeve e konferencave profesionale, si i tillë duhet të zhvillohet edhe në forma të tjera më të qëndrueshme e më sistematike si ajo e shkruar, e cila përveç tjerash siguron edhe përfshirje më të gjerë në terren.

Fakulteti i Edukimit e ka themeluar këtë revistë me qëllim që të ofrojë një platformë të komunikimit në komunitetin akademik dhe për të kontribuar në promovimin e shpërndarjen më të lehtë të nismave të ndryshme, praktikave të mira në sistem, por gjithashtu edhe për të inkurajuar shkëmbimin mes akterëve të ndryshëm në sistemin arsimor duke përfshirë: mësimdhënësit në institucionet e arsimit parauniversitar, mësimdhënësit në Fakultetin e Edukimit, hulumtuesit në sektorin e edukimit dhe politikëbërësit.

Revista, gjatë procesit, do të gjejë rrugën dhe formatin më të përshtatshëm për veten duke parë jo vetëm interesimin e lexuesit por edhe të kontribuesve. Ideja parësore është që të botohen shembuj e kontribute nga terreni, përmbledhje praktike të hulumtimeve shkencore rreth një teme të caktuar, si dhe sugjerime e mësim të nxjerra nga terreni për zgjidhjen e problemeve të caktuara në mjedisin arsimor duke përfshirë përmbledhje të hulumtimeve në veprim e të studimeve të rasti, shembuj të planeve mësimore, shembuj të projekteve e përmbledhje të projekteve por edhe reflektime të raportimeve për punë të mira e suksese në institucionet arsimore.

Zhvillimi i këtij debati akademik për sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë është i një rëndësie të madhe, meqë adreson mungesën e theksuar të praktikave të bashkëpunimit, rrjetëzimit dhe ndarjes së përvojave ndërmjet profesionistëve arsimorë dhe, si realitet i tillë, është në kundërshtim me trendet dhe praktikatat e mira të modelit të ri të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, ku bashkëpunimi kolegjial dhe mësimi nga njëri-tjetri janë bërthama e këtij procesi. Tanimë, është koha që edhe Kosova të mishërojë këto praktika më thellë në sistemin e vet të zhvillimit profesional të mësimdhënësve duke shënuar kështu edhe një angazhim tjetër në pasurimin me modele përtej atyre tradicionale siç janë seminarët e trajnimet.

Jemi të bindur që kjo revistë, nga njëra anë, do të jetë një forum i mirëfilltë ku mësimdhënësit do të mund të ndajnë praktikatat e mira, ndërsa nga ana tjetër, do të bëhet faktor në forcimin e lidhjes mes sistemit shkollor dhe institucioneve që përgatisin mësimdhënësit, hallkë kjo shumë e rëndësishme për të siguruar që përgatitja e mësimdhënësve të rinj të jetë sa më relevante. Kjo relevancë vlerësohet sot në raport me një kontekst që ka ndryshuar në baza të vazhdueshme dhe që ndërkohë pandalshëm po përjeton një zhvillim edhe më të hovshëm social e profesional. Ky zhvillim i hovshëm sqarohet e kuptohet duke marrë parasysh globalizimin, zhvillimin e teknologjisë dhe nevojën që sistemi jonë i arsimit nuk mund e nuk duhet të silltet inferior ndaj pjesës tjetër të familjes Evropiane ku edhe synohet integrimi politik e që në vete ngërthen edhe nevojën e përafërimit edhe në sektorin e arsimit.

Ky edicion i revistës është përgatitur si numër i parë promovues e pilotues në kuadër të një projekti bashkëpunues Evropian ku janë marrë disa shembuj nga partnerët, ndërkohë, puna do të vijojë në vendosjen e komunikimit me palët e tjera që të organizohen proceset e kontributit nga secila palë në mënyrë të vazhdueshme. Natyra e kontributeve është një gërshetim përmbledhës të fokusuar në hulumtime shkencore, modele të punës nga partnerët e ndryshëm dhe artikuj të tjerë informativë për mësimdhënësit e akterët e tjerë relevantë në Kosovë. Në formë të ftesës për bashkëpunim, ritheksojmë mesazhin që zgjidhja e problemeve në praktikatat arsimore shpesh gjendet brenda nesh, prandaj duhet të angazhohemi në proceset bashkëpunuese e eksploruese për t'i gjeneruar ato përmes praktikave reflektive me të cilat lidhet edhe synimi i nismës për të botuar revistën EduForum.

Në shkurt 2025 do të hapet thirrja për kontribute në numrin e dytë të revistës EduForum në platformat e Fakultetit të Edukimit dhe inkurajoheni të bashkëpunoni e kontriboni në vazhdimësi.

PËRMBAJTJA

Artikulli 1 - Strategjitë efektive për mentorimin e studentëve gjatë praktikës shkollore.....	5
Artikulli 2 - Integrimi i lëvizjeve në klasë	9
Artikulli 3 - Të nxënit socio-emocional në mjediset edukative	15
Artikulli 4 - Mjedise të vetë-mjaftueshme për një të ardhme të qëndrueshme: Doracak për mësimdhënës për vetëdijesimin dhe veprimin e vetë-mjaftueshëm në shkolla.....	21
Artikulli 5 - Teoria e ndryshimit e bazuar në vlera.....	32
Artikulli 6 - Aktivitetet e bazuara në kërkime në lëndën e kimisë në një mjedis arsimor joformal – njohuri nga projekti sloven DiSSI.....	37
Artikulli 7 - Mendësia Gjithëpërfshirëse.....	44
Artikulli 8 - Cilat janë risitë arsimore që synojnë shkollat estoneze?.....	48
Infografikë 1- T'i njohim dhe përkrahim kompetencat shkencore.....	52
Infografikë 2 - Praktikrat e mësimdhënies në shkollat e Kosovës sipas perspektivës së nxënësve - Rezultatet nga testi PISA 2018.....	53
Infografikë 3 - Ushtrime praktike për të nxitur mendimin kritik.....	56
Lajme dhe njoftime.....	57

STRATEGJITË EFEKTIVE PËR MENTORIMIN E STUDENTËVE GJATË PRAKTIKËS SHKOLLORE

Elmedina Nikoçeviq-Kurti, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

HYRJE

Pasi studentët të pranohen në programet për përgatitjen e mësuesve të ardhshëm, përvojat e tyre gjatë praktikës shkollore janë kontribuuesit më të rëndësishëm për perspektivën e tyre në profesion. Praktika shkollore është pjesë kritike e programeve për përgatitjen e mësimeve të ardhshëm dhe është dizajnuar për t'u dhënë studentëve mundësi që të ngrisin shkathtësitë rreth mësimit dhe të nxënësve. Programet për përgatitjen e mësimeve kanë marrë vëmendje të posaçme dhe studime të ndryshme në këtë fushë përpunon të shtjellojnë aspektet të rëndësishme që sigurojnë që të diplomuarit të jenë të përgatitur për të ofruar mësime për të gjithë nxënësit, pa dallim.

PRAKTIKA SHKOLLORE DHE MENTORIMI I STUDENTËVE

Gjatë praktikës shkollore, studentët kanë mundësinë të shohin mjedisin e punës dhe kulturën e shkollës, kurikulën dhe procesin e vlerësimit, por edhe ta shohin veten në rolin e mësimit. Gjithashtu, studentët mësojnë strategji efektive të mësimit, dhe zhvillojnë aftësitë e tyre menaxhuese e organizative. Duhet pasur parasysh, se gjatë programit të mentorimit, si mentori ashtu edhe studenti-praktikant, përfitojnë nga përvoja e mentorimit. Sigurimi i mentorëve të përgatitur dhe efektivë kontribuon në suksesin e studentëve gjatë kësaj periudhe të zhvillimit personal e profesional. Gjatë praktikës shkollore, studentët-praktikantë formojnë identitetin e tyre profesional dhe vetëfikasitetin për mësime. Kapaciteti i mësimeve para shërbimit, për të pasur sukses në një praktikë profesionale është i lidhur ngushtë me cilësinë e mësimit në shërbim (Ambrosetti, 2014; Wilson & Huynh, 2020). Nga mentorët pritet të tregojnë përgjegjësi morale dhe profesionalizëm për të ndihmuar mësimit para shërbimit që të përdorin njohuritë dhe aktivitetet e qëndrueshme profesionale që do të sigurojnë rezultate cilësore të nxënësve. Kësisoj, interesimi i studimit që të analizojnë se si mësimit e ardhshëm dhe institucionet përfitojnë nga mentorimi në arsimin e lartë, si dhe çfarë lloj programesh dhe politikash mentorimi janë më efektive, është gjithnjë e më i lartë.

MODELI PESËFAKTORËSH I MENTORIMIT PËR MËSIMDHËNIE EFEKTIVE

Instrumenti i vlerësimit të përvojës së studentëve gjatë mentorimit në praktikë shkollore zhvilluar nga Hudson et al. (2005), siguron një kornizë për mentorimin dhe mund të përdoret si një pikë referimi për praktikantët mentorues të atyre që punojnë me studentët-praktikantët. Ky instrument, vlerëson nivelin e kënaqshmërisë së studentëve me praktikantët mentorues të mësuesve mentorë sa u përket pesë aspekteve si: atributet personale të mentorit, kërkesat e sistemit, njohuritë pedagogjike, modelimi dhe informatat kthyes (shih Figurën 1.). Ky grup i faktorëve, u ofron zhvilluesve të programeve të mentorimit informacion për hartimin e strategjive specifike të mentorimit nga mentorët, të cilat mund t'i përdorin për përmirësimin e aftësive të mësimit të studentëve të tyre, por gjithashtu mund të sigurojë bazën për zhvillimin profesional për mentorët.




Figura 1. Modeli pesëfaktorësh për mentorim efektiv (Hudson et al., 2005)

CILËSIA E PËRVOJËS SË STUDENTËVE PRAKTIKANTË GJATË MENTORIMIT

Në studimin mbi përvojat e studentëve praktikantë gjatë mentorimit nga mentorët në shkolla (shih Nikoçeviq-Kurti, 2022) u anketuan 210 studentë të vitit të tretë dhe të katërt të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës, të cilët sapo kishin përfunduar praktikën shkollore.

Qëllimi i hulumtimit ishte të matet niveli i kënaqshmërisë së studentëve me ofrimin e pesë faktorëve të lartpërmendur gjatë mentorimit nga mësuesi mentor. Mesatarja e përgjithshme $M=3.91$ nga shkalla me 5 pikë tregon nivelin e kënaqshëm të përvojës të studentëve me mentorimin nga mësuesi mentor. Rezultatet tregojnë se studentët kanë nivelin më të lartë të kënaqshmërisë me atributet personale të mentorit ($M = 4.13$) dhe me modelimin e praktikave mësimore nga mentori ($M = 4.02$), ndërsa nivelin më të ulët të përvojës së mentorimit e shfaqin në ofrimin e informatës kthyes nga mentori në shkollë ($M = 3.61$).

Niveli i ulët i kënaqshmërisë së studentëve me ofrimin e informatës kthyesë nga mentori është indikatorë që studentët rrallë mbajnë orë mësimore dhe se mentorët nuk ofrojnë aq sa duhet informata kthyesë me shkrim dhe me gojë mbi performancën e studentëve gjatë praktikës. Studimi nxjerr në pah efektin e kulturës së mentorimit në të cilën mësimdhënësit mentorë i kushtojnë më pak vëmendje rolit të tyre si ofrues të informatës kthyesë. Po ashtu, studimi ka nxjerrë në pah se studentët që kanë përfituar më shumë nga mentorimi në aspektin etributeve personale të mentorit në shkollë, janë më të prirë të kenë nivel më të lartë të vetefikasitetit për mësimdhënie.

STRATEGJITË EFEKTIVE TË MENTORIMIT GJATË PRAKTIKËS

Studimi aktual, nga Nikoçeviq-Kurti (2023) ka eksploruar strategjitë efektive të mentorimit për të shpjeguar atotribute që avancojnë mentorimin pozitiv dhe proaktiv. Nëpërmjet një ekzaminimi të perceptimeve të mentorëve, profesorëve mbikëqyrës dhe studentëve, studimi sjell një kuptim më të thellë të atyre praktikave që ndikojnë në mënyrë më efektive në marrëdhëniet mentoruese ndërmjet studentëve dhe mentorëve. Theksohet nevoja e përgatitjes dhe përzgjedhjes më të mirë të profesorëve mbikëqyrës dhe mentorëve në shkollë të cilët mentorojnë studentët, por edhe dëshira e tyre të jenë në rolin e mentorit. Ndër të tjera, mentorët duhet t'i kenë të karta rolet dhe përgjegjësitë e tyre, por mbi të gjitha kompetencat që duhet t'i zhvillojnë për mentorim sa më efektiv të studentëve.

Preferohet që trajnimi i mentorëve të bëhet në harmonizim me pesë faktorët për mentorim efektiv (atributet personale, kërkesat e sistemit, njohuritë pedagogjike, modelimi dhe informatat kthyesë) duke qenëse studimet e Hudson-it kanë treguar se ata mentorë të cilët janë bazuar në këtë ornizë të faktorëve të mentorimit janë treguar më efektiv dhe kanë ofruar praktika më të mira të mentorimit.

Duke qenë se atributet personale të mentorëve determinojnë shfaqjen e vlerave personale dhe profesionale të tyre para studentëve, modelimi i cilësive të një mësimdhënësi të përgatitur dhe atraktiv para studentëve është më se i nevojshëm. Disa studentë vlerësojnë çiltërsinë, energjinë, përpikërinë, vetëbesimin, përkrahjen, mikpritjen e mentorit, derisa disa të tjerë, përveç këtyre, vlerësojnë edhe cilësitë e mentorit si të qënurit strikt, detajist, serioz, që kërkon respektim të rregullave, e të tjera. Pra, imazhi tërheqës i mësuesit mund të dallojë varësisht nga preferencat e studentit. Cilësitë e mentorëve si afërsia, përgjigjshmëria, interesimi për zhvillimin e studentit që mentorojnë, vullneti për mentorim, llogaridhënia, etj., janë indikatorë për krijimin e një raporti pozitiv dhe mbështetës ndërmjet mentorëve dhe studentëve.

KOSTOJA E NEGLIZHENCËS NË PROCESIN E MENTORIMIT TË STUDENTËVE

Kualiteti i përgatitjes së mentorëve dhe cilësia e praktikave të tyre mentoruese janë parakusht për sigurimin e cilësisë dhe standardit të praktikës shkollore. Sipas rezultateve të këtij studimi, kur mentorët e studentët nuk kanë vendosur marrëdhënie pozitive që nga takimet e para, studentët kanë përjetuar demoralizim, ankth, shqetësim dhe mosinteresim për praktikën shkollore. Krijimi i raportit të afërt mentor-student, hap rrugën për ofrimin e dimensioneve të tjera të mbështetjes për mentorim efektiv. Mësuesit mentorë dhe profesorët mbikëqyrës pajtohen se mentorimi është një proces sfidues, i mundimshëm, që kërkon kohë dhe përgjegjësi, por në anën tjetër theksojnë se ata kanë nevojë për motivim dhe lehtësim të këtij procesi. Si përfundim, vlerësimi i procesit dhe shërbimet mbështetëse mund të kontribuojnë në procesin e hartimit cilësor të programit mentorues të studentëve.



REFERENCAT

Ambrosetti, A. (2014). Are you ready to be a mentor? Preparing teachers for mentoring pre-service teachers. *Australian Journal of Teacher Education*, 39(6), 30-42. <http://dx.doi.org/10.14221/ajte.2014v39n6.2>

Hudson, P., Skamp, K., & Brooks, L. (2005). Development of an instrument: mentoring for effective primary science teaching. *Science Education*, 89(4), 657–674. <https://doi.org/10.1002/sce.20025>

Nikoçeviq-Kurti, E. (2022). Predictive power of five-factor mentoring model on student teachers' teaching self-efficacy beliefs. *European Journal of Educational Research*, 11(3), 1245-1257. <https://doi.org/10.12973/eu-jer.11.3.1245>

Nikoçeviq-Kurti, E. (2023, in press). Minding the challenges: exploring the meaning of practicum for development of student teachers' self-efficacy beliefs. *International Journal of Education Economics and Development*. <https://doi.org/10.1504/IJEED.2023.10048437>

Wilson, A., & Huynh, M. (2020). Mentor–mentee relationships as anchors for pre service teachers' coping on professional placement. *International Journal of Mentoring and Coaching in Education*, 9(1), 71-86. <https://doi.org/10.1108/IJMCE-04-2019-0052>

INTEGRIMI I LËVIZJEVE NË KLASË

Vesna Štemberger, Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Edukimit, Slloveni

HYRJE

Mënyra e jetesës së fëmijëve sot është e ndryshme nga ajo që ka qenë: ata kalojnë një sasi të tepërt të kohës ulur, para ekraneve dhe ushtrojnë pak dhe dobët. Stili modern i jetesës së një individi, dhe për rrjedhojë, tek fëmijët, tani përkufizohet si një mënyrë jetese e ulur ose sjellje e ulur, një mënyrë jetese në të cilën shpenzimi i energjisë është midis 1.0 dhe 1.5 shumëfish i shkallës metabolike bazale (METs) (Eanes, 2018), me 1.0 MET që korrespondojnë me shpenzimet e energjisë në pushim. Ai përcaktohet gjithashtu nga mungesa e aktivitetit fizik të moderuar deri në të lartë (Bauman et al., 2011).

Hulumtimet tregojnë se qëndrimi ulur për një kohë të gjatë (7 ose më shumë orë në ditë) dhe qëndrimi i zgjatur i vazhdueshëm ulur (30 minuta ose më shumë) ka efekte negative në shëndetin e personit, edhe kur aktiviteti fizik i moderuar deri në të lartë ndodh çdo ditë (Eanes, 2018). Mungesa e aktivitetit fizik shton lodhjen sepse kërkesat e larta njohëse, ngarkesat e punës dhe mungesa e pushimeve gjatë punës intelektuale (mësimi) i ngarkojnë trupit të nxënësit një barrë të rëndë. Mungesa e lëvizjes gjithashtu mund të çojë në dëmtim të shtyllës kurrizore dhe të gjithë sistemit muskuloskeletor (Jovanova-Mitkovska, Popeska, 2016, wynee-Jones et al., 2014). Ngarkesat emocionale dhe mungesa e pushimeve çojnë në lodhje emocionale dhe rraskapitje, ndërsa ngarkesat fizike dhe mungesa e pushimeve gjatë punës çojnë në probleme në fushën fizike (Brustio et al., 2018; De Jonge, Spoor, Sonntag, Dormann dhe van den Tooren, 2012). Është e qartë se natyra kryesisht e ulur e mësimdhënies, u vë stres të madh nxënësve.

Kjo ka çuar në një sërë përpjekjesh për të integruar aktivitetin fizik në klasë, duke u fokusuar jo vetëm në procesin e edukatës fizike, por edhe duke kërkuar mënyra të ndryshme për të integruar aktivitetin fizik në të gjitha lëndët dhe në jetën e përditshme të nxënësve.

Shkollat luajnë rol të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi nxënësit kalojnë një pjesë të madhe të ditës në shkollë. Një numër i madh kërkimesh tregojnë se integrimi i aktivitetit fizik në klasë në formën e minutave shëndetësore, pushimeve aktive, një mjedisi të favorshëm për aktivitet fizik, etj., ka ndikim të rëndësishëm në performancën akademike të fëmijëve, megjithëse përfshirja e pushimeve aktive mund të zvogëlojë paksa numrin e minutave të shpenzuara në lëndë të tjera shkollore (Powell et al., 2016; Brustio et al., 2018, Singh et al., 2012). Studimet tregojnë se rritja e sasisë së aktivitetit fizik ka ndikim pozitiv në performancën akademike të fëmijëve, ose të paktën nuk ka ndikim negativ në performancën akademike, kur rritja e aktivitetit fizik vije në kurriz të lëndëve të tjera shkollore (Kvalo et al., 2014; Alesi et al., 2016). Në fëmijëri dhe adoleshencë, aktiviteti fizik jo vetëm që ndikon në shëndetin individual, por gjithashtu ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e shprehive të qëndrueshme për një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aktive. Është e rëndësishme për zhvillimin e aftësive motorike dhe përvetësimin e aftësive motorike që u mundësojnë fëmijëve të përdorin me mençuri kohën e lirë më vonë në moshën madhore (Ridgers et al., 2006).

STRATEGJITË PËR INTEGRIMIN E LËVIZJEVE NË KLASË

Strategjitë ose ndërhyrjet e përdorura për të rritur sasinë dhe intensitetin e aktivitetit fizik të përditshëm mund të ndahen gjerësisht në dy lloje. Të parat janë të ashtuquajturat strategji tërheqëse, në të cilat ftojme nxënësin të marrë pjesë në një aktivitet. Këto janë të ashtuquajturat strategji të buta që zakonisht motivojnë një pjesë të vogël të nxënësve me një nivel shumë të lartë motivimi për të marrë pjesë (Titze, Martin, Seiler dhe Marti, 2001).

Lloji i dytë i strategjive janë të ashtuquajturat strategji "shtytjeje", në të cilat nxënësit e kanë të vështirë apo edhe të pamundur të shmangin fare aktivitetin fizik. Strategjitë e "shtytjes" përfshijnë ndryshimin e organizimit të mjedisit, organizimin e pushimeve aktive të detyrueshme, etj. Në një mënyrë ose në një tjetër, këto strategji përfshijnë nxënësit më pak të motivuar, të cilët nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të bëjnë ndryshime vetë.

NJË MJEDIS QË INKURAJON LËVIZJEN

Një mjedis që inkurajon lëvizjen është projektuar në mënyrë që vetë dizajni arkitektonik të ftojë ose dekurajojë lëvizjen. Kjo vlen jo vetëm për dizajnin e klasës, por edhe për dizajnin e mjedisit të shkollës në përgjithësi, duke përfshirë hapësirat e jashtme. Një mjedis që inkurajon lëvizjen krijohet për t'i bërë individët të ndihen të sigurt, të motivuar apo edhe të detyruar për të lëvizur (p.sh., shkallët lëvizëse që janë mjaft të ngushta dhe të ngadalta për t'i lejuar individët të udhëtojnë një distancë të caktuar më shpejt dhe me efikasitet). Pra, në lagjen e jashtme, ka parqe më të mëdha, më shumë zona rekreative, trotuare pothuajse kudo, korsi të sigurta (të ndara nga rruga dhe/ose mjaft të gjera) për biçikleta, shumë kënde lojërash për fëmijë, etj.

Mesazhet që shfaqen në mjedis, si mendime dhe thënie inkurajuese, tabela të ndryshme në shkallë dhe në ashensorë, mund të llogariten gjithashtu si pjesë e mjedisit miqësor ndaj lëvizshmërisë.

Në shkollë, një mjedis i tillë mund të krijohet në një mënyrë mjaft të thjeshtë. Ashensorët mund të zbkurohen me thënie motivuese për rëndësinë e ecjes për shëndetin dhe ruajtjen e natyrës duke reduktuar konsumin e energjisë elektrike. Në shkallë mund të vendosen tabela me mesazhe për konsumin e kalorive, përfitimet shëndetësore, etj.

Në mure mund të vendosen postera që inkurajojnë një mënyrë jetese të shëndetshme.

Në klasa, mund të vendosen disa topa fitnesi në vend të karrigeve për t'u ulur. Në klasa, disa nga tavolinat tradicionale mund të zëvendësohen me të ashtuquajturat tavolina kinetike ku nxënësit mund të punojnë në këmbë.

Figura 1: Një klasë që inkurajon lëvizjen



Figura 2: Mjedise që nxisin lëvizjen: një kombinim i shkallëve lëvizëse dhe shkallëve lëvizëse me shenja motivuese





Figura 3: Një mjedis që promovon lëvizjen: objektet e transportit publik që inkurajojnë transportin aktiv



Figura 4: Mjedis jo miqësor për lëvizjen: sipërfaqet e rrugëve pa trotuare i inkurajojnë njerëzit të përdorin transportin




Figura 5: Mjedis jo miqësor për lëvizjen: shkallë lëvizëse pa mundësi përdorimi të shkallëve të zakonshme

TRANSPORTI AKTIV

Një nga strategjitë për t'i bërë nxënësit të lëvizin për të ruajtur shëndetin e tyre është transporti aktiv. Në këtë kontekst, nxënësit dhe prindërit e tyre inkurajohen të ecin për në shkollë ose të përdorin transportin që kërkon fuqi njerëzore (p.sh., biçikleta, skuter, patina). Kjo kërkon infrastrukturë rrugore që mundëson transport aktiv të sigurt, ambiente të përshtatshme magazinimi për biçikleta, patina, etj., si dhe përdorimin e mjeteve të tjera të transportit. Kur prindërit i sjellin nxënësit në shkollë, këshillohet që të sigurohet një vend i sigurt të paktën 500 m nga hyrja e shkollës ku nxënësit mund të zbresin dhe të përshëndeten me prindërit.

Në zonat ku ka rrugë më pak të sigurta për në shkollë, ose ku duam që nxënësit më të vegjël të shkojnë në shkollë, ka kuptim të prezantohet një "autobus me qëndrim në këmbë". Ideja e një "Autobusi me qëndrim në këmbë" është që nxënësit të mbledhen në një vend të sigurt dhe më pas të ecin për në shkollë të shoqëruar nga një i rritur (vullnetarë në pension, punonjës të shërbimit publik, mësime, etj.). E njëjta gjë vlen edhe për mbërritjen në shkollë me biçikletë ose patina. Nxënësit gjithashtu mbledhen në një vend(e) të sigurt dhe më pas me biçikletë/vijnë për në shkollë të shoqëruar nga një i rritur.

PUSHIMI AKTIV

Pushimi aktiv mund të përkufizohet si pushim i organizuar (i udhëhequr) gjatë orëve të shkollës për të përmirësuar shëndetin fizik dhe mendor. Ky lloj pushimi zgjat nga 20 deri në 30 minuta dhe zakonisht organizohet dhe drejtohet nga mësime dhe edukatës fizike në bashkëpunim me mësime të tjerë në shkollë.

Zakonisht, një pushim integrohet në orën e mësimit, por nëse nxënësit kalojnë gjithë ditën në shkollë, mund të organizohen dy pushime. Aktivitetet gjatë pushimit aktiv mund të kryhen me të njëjtat veshje që nxënësit bartin në shkollë.

Përmbajtja e pushimit aktiv mund të ndryshojë, por kryesisht u referohet lojërave të ndryshme sportive të përshtatshme për nxënësit, vallëzimit, zgjatjes, ushtrimeve të forcës, ushtrimeve aerobike. Nëse është e mundur, përmbajtja duhet të ndërrohet në mënyrë që secili nxënës të gjejë një aktivitet që i pëlqen më shumë dhe të ndihet rahat me të.

Pushimi aktiv duhet të kryhet në një vend të përbashkët, i cili mund të jetë klasa, palestra, korridori, natyra, etj. Është e rëndësishme që hapësira të jetë mjaft e madhe për të gjithë pjesëmarrësit dhe të jetë gjithmonë e disponueshme gjatë pushimit aktiv.



Figura 6: Shembull i shënimit të një zone të sigurt për nxënësit që dalin nga makina

NJË MINUTË PËR SHËNDET

Një minutë shëndetësore, ose i ashtuquajtimi mikro pushim, është një pushim i shkurtër deri në 5 minuta gjatë punës (së ulur). Minuta e shëndetit drejtohet nga mësimdhënësi. Puna ulur duhet të ndërpritet kur vërejmë se nxënësit nuk janë në gjendje të përqendrohen më, ulet përqendrimi, përgjumen... Kjo mund të ndodhë një herë ose disa herë në një njësi mësimore. Gjatë kësaj kohe, mësimdhënësi demonstroi 2 deri në 4 detyra lëvizjeje (zgjatje, ushtrime forcuese, vallëzim, meditim, ecje etj.) dhe nxënësit i përsërisin ato. Është e rëndësishme që dhoma (klasa) të jetë e ajrosur mirë.

Periudhat e relaksimit janë të ngjashme me minutat e shëndetit pasi ato janë ndërprerje të shkurtra në mësim për t'i ndihmuar nxënësit të pushojnë, të lehtësojnë stresin dhe të mblidhen më lehtë përmes aktiviteteve të ndryshme të drejtuara. Lëvizjet e kontrolluara të relaksimit ose aktivitetet e lëvizjes kryhen për të përqendruar mendjen te njerëzit, objektet, fenomenet mendore ose trupi. Kështu, fazat e relaksimit kanë efekt qetësues dhe reduktues të stresit, çojnë në një fikje afatshkurtër dhe reduktojnë tensionin e muskujve, shqetësimin e brendshëm, parandalojnë ndjenjat e stresit dhe rrisin aftësinë për t'u përqendruar dhe në përgjithësi kontribuojnë në një atmosferë më të këndshme në klasë (Müller, 2010).

PËRFUNDIM

Integrimi i aktivitetit fizik në jetën e përditshme të nxënësve është kritik për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së procesit arsimor. Inkuadrimi i lëvizjes mund të parandalojë ose të paktën të zbusë pasojat negative të një stili jetese të ulur, lodhjen për shkak të mbingarkesës nga puna e njëanshme, stresin nga ngarkesat e pabarabarta (të njëanshme), humbjen e vëmendjes dhe përqendrimit, etj.

Strategjitë e zgjedhura për të integruar aktivitetin fizik në klasë varen kryesisht nga mosha e nxënësve, njohuritë dhe vullneti i mësimdhënësve për të ndryshuar, mbështetja nga administratorët e shkollës dhe për disa strategji nga kërkesat materiale. Disa strategji mund të integrohen në klasë menjëherë dhe pa kosto shtesë. Këto përfshijnë minutat e shëndetit, pushimin aktiv, shenjat motivuese në klasa, korridore dhe zona të tjera të përbashkëta. Më sfiduese janë strategjitë që kërkojnë më shumë burime materiale dhe njerëzore. Këto përfshijnë ndryshimin e mjedisit të afërt të shkollës (planifikimin dhe rregullimin e rrugëve të sigurta për në shkollë), rimodelimin e klasave për të lejuar më shumë lëvizje (zëvendësimin e pajisjeve dhe instalimin e të paktën disa pajisjeve që mundësojnë uljen aktive apo edhe punën gjatë qëndrimit në këmbë).

Megjithatë, faktori më i rëndësishëm në integrimin e të gjitha këtyre strategjive është faktori njerëzor. Prandaj, mbështetja dhe inkurajimi nga udhëheqja e secilës organizatë është kritike, siç është vetëdijësimi për rëndësinë e integrimit të lëvizjes në procesin e mësimdhënies për të përmirësuar cilësinë e saj.

REFERENCAT

- Alesi, M., Bianco, A., Luppina, G. in Palma, A. (2016). Improving Children's Coordinative Skills and Executive Functions: The Effect of a Football Exercise Program. *Percept Mot Skills*, 122(1), 27–46. doi: 10.1177/0031512515627527
- Bauman, A., Ainsworth, B. E., Sallis, J. F., Hagströmer, M., Craig, C. L., Bull, F. C., Pratt, M., Venugopal, K., Chau, J., Sjöström, M. (2011). The Descriptive Epidemiology of Sitting. A 20-Country Comparison Using the International Physical Activity Questionnaire (IPAQ). *American Journal of preventive Medicine*, 41(2), 228-235. doi: 10.1016/j.amepre.2011.05.003
- Brustio, P. R., Moise, P., Marasso, D., Miglio, F., Rainoldi, A. in Boccia, G. (2018). Feasibility of implementing an outdoor walking break in Italian middle schools. *PLoS ONE*, 13(8), e0202091. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0202091>
- De Jonge, J., Spoor, E., Sonnentag, S., Dormann, C. in van den Tooren, M. (2012). »Take a break?!« Off-job recovery, job demands, and job resources as predictors of health, active learning, and creativity. *European Journal of Work and Organizational Psychology*, 21(3), 321–348. <https://doi.org/10.1080/135943X.2011.576009>
- Eanes, L. (2018). CE: Too much sitting a newly recognized health risk. *AJN The American journal of nursing*, 118(9), 26–34. Pridobljeno s https://journals.lww.com/ajnonline/Fulltext/2018/09000/CE_Too_Much_Sitting_A_Newly_Recognized_Health.27.aspx
- Jovanova – Mitkovska, S., Popeska, B. (2016). Management with time, academic obligation and possibilities for active break for the teaching staff at the Faculty of Educational Sciences at Goce Delcev University in Stip-Macedonia. *Activities in Physical Education and Sport*, 6(2), 257-260.
- Kvalo, S. E., Bru, E., Bronnick, K. in Dyrstad, S. M. (2017). Does increased physical activity in school affect children's executive function and aerobic fitness? *Scandinavian Journal of Medicine in Science in Sports* 27(12), 1833–1841.
- Müller, C. (2010). Active primary school – Aspects of didactics of physical education a comprehensive task of primary school. Sankt Augustin: Academia Verlag.
- Powell, E., Woodfield, L. A. in Nevil A. M. (2016). Children's physical activity levels during primary school break times: A quantitative and qualitative research design. *European Physical Education Review*, 22(1), 82–98.
- Ridgers, N., Stratton, G. in Fairclough, S. J. (2006). Physical Activity Levels of Children during School Playtime. *Sports Med*, 36, 359–371. <https://doi.org/10.2165/00007256-200636040-00005>
- Singh, A., Uljtewillingen, L., Twisk, J., Van Mechelen, W. in Chinapaw, M. (2012). Physical activity and student performance at school. A systematic review of the literature including a methodological quality assessment. *Archives of Pediatrics and Adolescent Medicine*, 166 (1), 49–55.
- Titze, D., Martin, B. W., Seiler, R., Marti, B. (2001). A worksite intervention module encouraging the use of stairs: results and evaluation issues. *Soz Präventivmed*, 46(1), 13-19.
- Wynne-Jones, G., Cowen, J., Jordan, J. L., Uthman, O., Main, C. J., Glozier, N. & Van der Windt, D. (2014). Absence from work and return to work in people with back pain: A systematic review and meta-analysis. *Occup Environ Med.*, 71(6), 448-456. doi: 10.1136/oemed-2013-101759

BURIMET E FOTOGRAFIVE

Foto 1: <http://performancepyramid.miamioh.edu/node/1393>

Foto2: <https://www.semanticscholar.org/paper/Promoting-stair-climbing-in-public-access-settings%3A-Webb-Smith/515e94fd8d842d1b7acac5ea5ecd785a8f0abe75>

Foto 3: <https://www.pinterest.co.kr/pin/455919162253009707/>

Foto 4: <https://www.spokesman.com/stories/2011/nov/20/proceed-with-caution/>

Foto 5: https://en.wikipedia.org/wiki/Escalator#/media/File:Copenhagen_Metro_escalators.jpg

Foto 6: <https://www.artlessonsonline.com.au/parkhurst-ss-kiss-go-sign-artwork/>

TË NXËNIT SOCIO-EMOCIONAL NË MJEDISET EDUKATIVE

Blerta Perolli Shehu, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

HYRJE

Për një kohë të gjatë, shkathtësitë emocionale dhe sociale janë konsideruar karakteristika intrinzike të personalitetit, të lindura dhe të pandryshueshme. Teoria e të mësuarit social e Albert Banduras në vitet e 60ta ka sjellë një konceptualizim të ri të tyre, që e mundësoi edhe futjen e tyre në modelet e ndërhyrjes në edukim. Kjo teori i konsideronte ndërveprimet njerëzore si sjellje të dukshme që lehtësisht mund të maten dhe theksonte se aspektet socio-emocionale formësohen bazuar në konceptet e të nxënimit, që për dallim nga tiparet intrinzike të personalitetit, janë të ndryshueshme përmes proceseve të të nxënimit dhe nga ndërveprimi mes individit dhe mjedisit. Kur kompetencat socio-emocionale u definuan kështu, u përcaktua edhe që mund të përdoren ndërhyrje të strukturuar në mjedise familjare dhe edukative dhe në parimet e të nxënimit (Rathjen & Foreyt, 2013).

Sjelljet, aftësitë dhe vlerat sociale dhe emocionale mund, dhe duhet të mësohen, dhe për këtë kërkohet angazhimi dhe modelimi pozitiv nga prindërit dhe edukatorët. Kur mendojmë për gatishmërinë e fëmijëve për të ndjekur institucionin edukativ, zakonisht tendenca e shumicës është të përqëndrohemi tek shëndeti fizik dhe mendor i fëmijës dhe aftësitë për kujdes personal. Por, gatishmëria socio-emocionale nuk duhet të anashkalohet këtu, duke qenë se vë themelin për zhvillimin dhe të mësuarit e mëvonshëm. Pjekuria sociale dhe emocionale e fëmijës është qenësore për tu konsideruar si faktor kur matet gatishmëria e fëmijës për jetë të pavarur. Kjo pjekuri i ndihmon fëmijët të zhvillojnë reziliencë, të marrin veten pas situatave të pakëndshme, të përballen me sfida dhe të zhvillojnë aftësi për të menaxhuar emocionet e fuqishme. Ajo ndihmon të krijojnë dhe ruajnë marrëdhëniet pozitive me të tjerët, të kuptojnë ndjenjat e tyre dhe të respektojnë ndjenjat e të tjerëve, duke mundësuar edhe zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit dhe komunikimit. Gatishmëria socio-emocionale është një aspekt i domosdoshëm për zhvillim personal dhe akademik, për të pasur sukses në mjedisin shoqëror dhe për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e jetës.

Korniza Kurrikulare në Kosovë, në qëllimet e veta, thekson se nxënësit duhet të angazhohen në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve; të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik; të përkraken që të zhvillojnë përgjegjësinë për veten dhe të tjerët; dhe të përkraken që të zhvillojnë vetëbesimin dhe motivimin. Kompetenca personale, si një nga gjashtë kompetencat e kurrikulës, përfshin të kuptuarit e vetes dhe të tjerëve; besimin në vetvete; menaxhimin e emocioneve, ushtrimin e empatisë për të tjerët, si dhe bërjen e zgjedhjeve të përgjegjshme. Kjo na vendos të gjithëve në përgjegjësi për të kultivuar të nxënimit socio-emocional në praktikën arsimore. Idealisht, fëmijët do t'i zhvillojnë këto kompetenca vetë, të ndikuar nga faktorë biologjikë dhe mjedisorë; megjithatë, kjo nuk ndodh gjithmonë. Studimet sugjerojnë se ka shumë faktorë që ndikojnë në zhvillimin e kompetencave sociale dhe emocionale, duke përfshirë karakteristikat individuale të fëmijës, mjedisin familjar dhe mjedisin shkollor (Perolli-Shehu, 2019). Dhe, megjithëse, zhvillimi i kompetencave sociale dhe personale konsiderohet thelbësor në kurrikulën shtetërore, vendi jonë nuk ka iniciativë ose ndërhyrje të drejtpërdrejta që do të mbështesnin zhvillimin e këtyre kompetencave tek fëmijët. Për edukatorët e fëmijërisë së hershme dhe mësuesit e edukimit fillor, të kultivuarit e të nxënimit socio-emocional është pjesë kritike e krijimit të një mjedisi klase ku fëmijët ndihen të sigurt, të vlerësuar dhe të gatshëm për të mësuar.



TË NXËNIT SOCIO-EMOCIONAL - SEL (SOCIO-EMOTIONAL LEARNING)

Të nxënit socio-emocional (SEL) është një pjesë e pandashme e arsimit dhe zhvillimit njerëzor. Është aspekt themelor për zhvillimin holistik të një fëmije, duke formuar jo vetëm aftësinë e tyre për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhëniet ndërpersonale, por edhe kapacitetin e tyre për sukses akademik dhe jetësor. Sipas kornizës CASEL (2012), SEL është procesi përmes të cilit fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit fitojnë dhe aplikojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet për të zhvilluar identitete të shëndetshme, për të menaxhuar emocionet, për të arritur qëllime personale dhe kolektive, për të ndjerë dhe shfaqur empati për të tjerët, për të krijuar dhe ruajtur marrëdhënie mbështetëse, dhe për të marrë vendime të përgjegjshme. Sot, edukatorët dhe psikologët janë të interesuar për vlerësimin dhe promovimin e të nxënit socio-emocional (SEL) që në moshat e hershme.

Gjatë fillimit të viteve 1990, Collaborative for Academic, Social, and Emotional Learning (CASEL) përpiqej të organizonte rezultatet nga dekada kërkimesh empirike mbi zhvillimin socio-emocional në një kornizë të të nxënit socio-emocional (SEL) (Newman & Dunsunbury, 2015). Që nga atëherë, korniza CASEL është përdorur gjerësisht nga studiuesit, profesionistët dhe politikëbërësit, duke informuar kështu zhvillimin e politikave arsimore, standardeve të mësimin dhe praktikave në mjediset edukative.

Sipas kërkuesve të CASEL, SEL është procesi i të mësuarit për "të integruar mendimin, ndjenjat dhe veprimet për të arritur detyra të rëndësishme në jetën e përditshme" (Zins et al., 2007, f. 194). Rëndësia e këtyre aftësive, shpesh të referuara si aftësi jokognitive, aftësi "të buta" ose aftësi të karakterit, për të promovuar një zhvillim të përgjithshëm të shëndetshëm, theksohet në studime të shumta (Durlak et al., 2011). Korniza SEL e CASEL mbështetet në kërkime mbi zhvillimin tipik dhe atipik socio-emocional dhe thekson pesë fusha kryesore të kompetencave të paraqitura në diagramin më poshtë:



Diagrami 1 Kompetencat kryesore SEL (CASEL 2012)

Vetëdija personale përfshin aftësitë për të kuptuar emocionet, mendimet dhe vlerat e individit dhe si ato ndikojnë në sjelljen e tij/saj në kontekste të ndryshme. Ky proces përfshin njohjen e anëve të forta dhe kufizimeve personale, duke krijuar një ndjenjë të fortë kompetence. Disa shembuj përfshijnë kuptimin e emocioneve dhe reagimin ndaj tyre në mënyrë konstruktive, reflektimin mbi bindjet dhe paragjykimet personale që na ndikojnë në sjellje, si dhe besimin në aftësitë tona për të arritur qëllimet.

Menaxhimi i vetes është aftësia për të menaxhuar emocionet, mendimet dhe sjelljet në mënyrë efektive, për të arritur qëllimet personale. Kjo përfshin aftësinë për të pritur ose pasur durim për realizim të dëshirave/qëllimeve dhe aftësinë për të arritur qëllime personale dhe kolektive. Disa shembuj përfshijnë kontrollimin e emocioneve në situata të ndryshme, përcaktimin e qëllimeve për veten dhe grupin, përdorimin e aftësive të planifikimit dhe organizimit, dhe shfaqjen e guximit për të marrë iniciativë.

Vetëdija sociale është aftësia për të kuptuar këndvështrimet e tjerëve dhe për të ndjerë empati për të tjerët. Ky proces përfshin edhe aftësinë për të kuptuar normat sociale të sjelljes në situata të ndryshme dhe për të njohur burimet dhe mbështetjet që ofrohen nga mjedisi. Disa shembuj përfshijnë të kuptuarit e pikëpamjeve dhe përvojave të të tjerëve, vlerësimin e cilësive dhe aftësive të individëve të tjerë, dhembshuria për ndjenjat e të tjerëve, identifikimi i normave të padrejta, dhe të kuptuarit e mundësive dhe kufizimeve që sjell çdo situatë.

Aftësitë e ndërtimit të marrëdhënieve janë aftësitë për të krijuar dhe ruajtur marrëdhënie të shëndetshme dhe mbështetëse me individë dhe grupe të ndryshme. Ky proces përfshin aftësinë për të komunikuar qartë, për të dëgjuar aktivisht, për të bashkëpunuar, për të zgjidhur probleme në mënyrë konstruktive, për të udhëhequr dhe për të kërkuar ose ofruar ndihmë kur është e nevojshme. Disa shembuj përfshijnë marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët, respekt për diversitetin në marrëdhënie, bashkëpunim për qëllime të përbashkëta, dhe vetëdije për të drejtat dhe mirëqenien e individëve të tjerë.

Vendimmarrja e përgjegjshme është aftësia për të bërë zgjedhje konstruktive për sjelljen personale dhe ndërveprimet shoqërore në situata të ndryshme. Ky proces përfshin aftësinë për të vlerësuar përfitimet dhe pasojat e veprimeve të ndryshme për mirëqenien personale, sociale dhe kolektive. Disa shembuj përfshijnë të përdorësh të dhënat për të marrë vendime të informuara, të gjesh mënyra për të zgjidhur sfida dhe probleme, të mendosh për pasojat që mund të ketë një veprim përpara se ta kryesh atë, të përdorësh mendimin kritik në çdo aspekt të jetës, të analizosh ndikimet që veprimet e tua kanë në nivele të ndryshme shoqërore.

Në mjediset arsimore, këto aftësi zhvillohen përmes aktiviteteve të strukturuar dhe ndërveprimeve të përditshme.

Pse është i rëndësishëm SEL në mjediset arsimore?

Hulumtimet tregojnë vazhdimisht se integrimi i SEL në mjediset edukative kontribuon në:

- **Zhvillimin e aftësive për menaxhimin e emocioneve:** Fëmijët mësojnë të njohin, të kuptojnë dhe të menaxhojnë emocionet e tyre, duke i ndihmuar të përballen me situata të ndryshme me qetësi dhe vetëkontroll.
- **Ndërtimin e marrëdhënieve pozitive:** Ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi sociale, si empatia, komunikimi efektiv, bashkëpunimi, që janë kyçe për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme me bashkëmoshatarët dhe të rriturit.
- **Performancë të përmirësuar akademike:** Fëmijët tregojnë përmirësime të ndjeshme në përqendrimin dhe aftësitë e të nxëniet, duke ndikuar pozitivisht në suksesin akademik.
- **Reduktimin e sjelljeve problematike:** Ndihmon në uljen e konflikteve dhe sjelljeve të papërshtatshme, duke krijuar një mjedis më të sigurt dhe më mbështetës për mësimdhënie.
- **Nxijten e mirëqenies emocionale:** Ndërton reziliencë personale dhe zvogëlon stresin, ankthin dhe depresionin.

Për më tepër, këto aftësi kanë efekt zinxhiror në dinamikën e klasës, duke krijuar një mjedis pozitiv mësimor ku fëmijët mbështesin njëri-tjetrin dhe ndihen të fuqizuar për angazhim dhe pjesëmarrje.

STRATEGJI PRAKTIKE PËR INTEGRIMIN E TË NXËNIT SOCIO-EMOCIONAL

Teoria e të nxënës social Bandura-s thekson rolin e vëzhgimit dhe modelimit në përvetësimin e sjelljeve të reja. Kjo teori pohon se fëmijët mësojnë jo vetëm përmes udhëzimeve të drejtpërdrejta, por edhe duke vëzhguar dhe imituar të tjerët në mjedisin e tyre.

Për SEL, teoria e të nxënës social nënvizon rëndësinë e:

- Modelimit të sjelljeve të përshtatshme sociale dhe emocionale
- Ofrimit të mundësive për fëmijët që të praktikojnë këto sjellje
- Dhënies së përfundimit pozitiv për veprime prosociale

Inkorporoni SEL në rutinat ditore

Fëmijët mësojnë gjatë rutinave ditore, dhe përfshirja e aktiviteteve SEL në rutina ditore shndërrohet gradualisht në shprehje. Mund të filloni ditën me një "kontroll emocional", ku fëmijët shprehin ndjenjat e tyre duke përdorur figura, ngjyra ose fjalë. Gjatë kohës së diskutimeve, mund të diskutoni për miqësinë dhe zgjidhjen e problemeve, duke inkurajuar fëmijët të ndajnë mendimet e tyre. Përdorni kohën e tregimeve për të diskutuar emocionet, sjelljet dhe zgjedhjet e personazheve, me pyetje si, "Si mendoni se ndihen personazhet? Çfarë do të kishit bërë në vendin e tyre?" Kjo ndihmon fëmijët të zhvillojnë empati dhe të mendojnë për perspektiva të tjera. Simuloni situata sociale ku fëmijët praktikojnë ndihmën për shokët e klasës dhe kuptimin e nevojave të të tjerëve. Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës, ku rregullat krijohen së bashku me fëmijët dhe gjithmonë forcohet mirësia, siguron që çdo fëmijë të ndihet i respektuar dhe i vlerësuar.

Nxiti marrëdhëniet e shëndetshme midis fëmijëve

Kur fëmijët mësojnë të punojnë së bashku dhe të zgjidhin konflikte, ata zhvillojnë aftësi sociale që do t'u shërbejnë gjatë gjithë jetës. Aktivitetet bashkëpunuese, si projektet grupore, i ndihmojnë fëmijët të vlerësojnë idetë e të tjerëve dhe të punojnë për një qëllim të përbashkët, duke krijuar lidhje shoqërore të forta dhe aftësi zgjidhjeje problemesh. Përdorni aktivitete që inkurajojnë bashkëpunimin, si ndihma në projekte ose zgjidhja e problemeve së bashku. Mësoni fëmijët të përdorin teknika të zgjidhjes së konflikteve, si deklaratat "Unë ndihem... sepse..." dhe inkurajoni dëgjimin aktiv dhe diskutimin për të gjetur zgjidhje.

Bashkëpunoni me familjen

Prindërit janë partnerë kyç për të forcur mësimet e klasës edhe në shtëpi. Mbështetja e dyanshme ndihmon fëmijët të ndihen të sigurt dhe të zhvillojnë aftësi emocionale në një mjedis të qëndrueshëm dhe të harmonizuar. Punëtoritë për prindërit janë një mënyrë e fuqishme për të ndarë rëndësinë e SEL dhe për t'u ofruar atyre këshilla konkrete për zhvillimin e këtyre aftësive në shtëpi. Ky bashkëpunim ndërton një rrjet mbështetës që përmirëson marrëdhëniet dhe zhvillimin e fëmijëve.

Modeloni aftësitë socio-emocionale

Fëmijët mësojnë duke vëzhguar dhe imituar të rriturit. Modeloni empati, dëgjim aktiv dhe zgjidhje konflikti për t'i ndihmuar të menaxhojnë emocionet dhe marrëdhëniet. Shpjegoni mendimet tuaja me zë, p.sh.: "Jam i/e zhgënjyer, do marr frymë thellë para se të flas," për të treguar menaxhimin e emocioneve.

Krijoni një mjedis të sigurt dhe përfshirës

Kur fëmijët janë të pranuar, ata janë më të gatshëm të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre, duke kontribuar në një atmosferë të hapur dhe mbështetëse. Përdorni rregulla të qarta dhe sinjale vizuale që ndihmojnë fëmijët të kuptojnë pritshmëritë dhe të menaxhojnë emocionet dhe sjelljet. Vendosni rregulla të dukshme që promovojnë respektin dhe mirësinë, si "Respekto gjithmonë të tjerët", dhe ilustroni ato me imazhe pozitive. Përdorni sinjale vizuale si "grafikët e emocioneve" për të ndihmuar fëmijët të identifikojnë dhe shprehin emocionet e tyre. Sigurohuni që çdo fëmijë të ndihet i dëgjuar dhe i vlerësuar, duke ofruar mundësi për të kontribuar në aktivitete individuale dhe grupore. Kushtoni vëmendje fëmijëve më të heshtur dhe ofroni mundësi të barabarta për shprehje.

Mësoni teknikat e vet-rregullimit emocional

Teknikat e thjeshta për t'u qetësuar, si frymëmarrja e thellë ose përdorimi i një "këndi të qetë," mund të ndihmojnë fëmijët të përballesh me mirë me sfidat dhe të marrin vendime të mençura. Këto teknika iu ndihmojnë të ndihen të kontrolluar dhe të sigurt, duke mundësuar zhvillimin pa ngurrime emocionale. Integrimi i ushtrimeve të ndërgjegjësimit, si frymëmarrja e thellë, numërimi deri në dhjetë, ose përdorimi i një këndi qetësie kur emocionet janë të forta, ndihmon fëmijët të rifokusohen kur ndihen të stresuar, të çlirojnë tensionin dhe të rifitojnë qetësinë.

Nxiti marrjen e vendimeve të përshtatshme

Aktivitetet që inkurajojnë reflektimin dhe vlerësimin e pasojave të vendimeve ndihmojnë fëmijët të kuptojnë rëndësinë e zgjedhjeve të drejta dhe të përgjegjshme. Përdorni aktivitete që nxisin vendimmarrjen në situata të përditshme, si simulime të situatave që kërkojnë vendime dhe analizë të pasojave. Këto aktivitete ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi për të bërë zgjedhje të menduara dhe etikisht të drejta. Inkurajoni reflektimin mbi pasojat e vendimeve, duke diskutuar "Çfarë vendimesh morëm dhe si ndikuan ato?" Ky lloj reflektimi ndihmon fëmijët të kuptojnë ndikimin e veprimeve të tyre tek të tjerët. Përdorni modele vendimmarrjeje të thjeshta, ku fëmijët mund të analizojnë opsionet dhe të bëjnë zgjedhje të drejta, duke ndjekur hapa si: (a) identifikimi i mundësive, (b) analiza e pasojave, (c) zgjedhja e opsionit më të mirë, dhe (d) vlerësimi i rezultatit. Inkurajoni analizën e pasojave afatgjata për të ndihmuar fëmijët të mendojnë edhe për pasojat afatgjata për ta dhe për të tjerët. Kjo ndihmon fëmijët të zhvillojnë një kuptim më të thellë të përgjegjshmërisë në vendimmarrje.

VLERËSIMI I ZHVILLIMIT TË SEL

Vlerësimi i zhvillimit të aftësive socio-emocionale është një proces që mund të zhvillohet në mënyrë joformale dhe të vazhdueshme, duke përfshirë një gamë të gjerë metodash që e bëjnë të mundur monitorimin e ndryshimeve dhe rritjes së këtyre aftësive. Kjo qasje e vlerësimit mund të bëhet duke përdorur vëzhgimin e përditshëm, aktivitete reflektimi dhe metoda të tjera të strukturuar që i japin mundësi fëmijëve të përfshihen në procesin e mësimit dhe zhvillimit të aftësive të tyre socio-emocionale.

Vëzhgimi dhe regjistrimi i sjelljeve

Vëzhgimi i situatave të zakonshme ditore si fëmijët trajtojnë konfliktet, shprehin emocionet ose ndërveprojnë me bashkëmoshatarë, mund të japë një pasqyrë të vlefshme mbi zhvillimin e aftësive të tyre socio-emocionale. Gjatë një aktiviteti grupor, mund të vëzhgohet se si fëmijët reagojnë kur ndodhin mosmarrëveshje ose kur duhet të ndajnë materiale mes vete. Vëzhgimi i situatave kur fëmijët demonstrojnë mirësi, empati, ose aftësi për të zgjidhur problemet ofron informacion mbi progresin e tyre. Ky lloj vlerësimi është i dobishëm për të identifikuar fëmijët që mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë ose për të njohur ata që po zhvillohen mirë në këto fusha.

Vlerësimi nëpërmjet aktiviteteve të bazuara në lojë dhe bashkëpunim

Lojërat bashkëpunuese, loja me role dhe simulimet e situatave mund të përdoren për të monitoruar zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit, vendimarrjes, udhëheqjes dhe menaxhimit të emocioneve. Aktivitetet ku fëmijët duhet të bashkëpunojnë për të zgjidhur një problem ose për të përfunduar një detyrë, ofrojnë mundësi të shumta për të vëzhguar aftësitë e tyre në përbashkëpunim të presionit, zgjidhjen e konflikteve, ndarjen e burimeve dhe bashkëpunimin për të arritur një qëllim të përbashkët.

Aktivitetet e reflektimit dhe pyetjet e hapura

Aktivitetet që mundësojnë reflektimin mbi emocionet dhe ndjenjat ofrojnë një mundësi për të vlerësuar aftësitë që të shprehin veten dhe të reflektojnë mbi situata të ndryshme emocionale. Përdorimi i pyetjeve të hapura, si "Si u ndjeve kur...?" ose "Çfarë mund të kishe bërë ndryshe në këtë situatë?", i ndihmon fëmijët të përvetësojnë aftësitë e menduarit të thellë dhe analizimin e ndjenjave të tyre. Ky lloj aktiviteti u mundëson fëmijëve të bëjnë lidhjen midis mendimeve, emocioneve dhe sjelljeve të tyre, duke kontribuar në zhvillimin e vetëdijes emocionale dhe vetëkontrollit, dhe na ndihmon të vlerësojmë progresin e tyre në këtë aspekt.

Vetëkontrolli dhe marrja e vendimeve të përgjegjshme

Mund të përfshijë aftësinë e fëmijëve për të kontrolluar impulsivitetin dhe për të mbajtur një qëndrim të qetë kur marrin vendime. Aktivitetet që kërkojnë menaxhimin e stresit, si përballja me një situatë të vështirë ose kërkesa të shumfishta, mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të vetëkontrollit dhe të marrjes së vendimeve të mençura. Në një projekt grupor, fëmijët mund të ndeshen me sfida të papritura që kërkojnë reagime të shpejta. Vëzhgimi i mënyrës se si ata reagojnë dhe marrin vendime në kushte stresi ose presioni mund të ofrojë informacione të vlefshme për zhvillimin e aftësisë për të mbajtur kontrollin dhe për të marrë vendime të drejta dhe të mirë-menduar.

PËRFUNDIMI

Të nxënit socio-emocional nuk është një pjesë e veçantë e kurrikulës apo e lëndës suaj; ai është i integruar në ndërveprimet dhe mësimdhënien tuaj të përditshme. Duke i dhënë përparësi SEL, ju pajisni fëmijët me aftësitë që u nevojiten për të pasur sukses brenda dhe jashtë klasës. Me durim dhe kreativitet, ju mund ta bëni SEL një gur themel të praktikës suaj të mësimdhënies, duke nxitur një brez nxënësish emocionalisht inteligjentë, empatikë dhe të qëndrueshëm. Filloni me hapa të vegjël, jini të qëllimshëm dhe shikoni se si këto praktika transformojnë jo vetëm klasën tuaj, por edhe jetët e nxënësve tuaj.

Vlerësimi i zhvillimit të empatisë dhe vetëkontrollit

Mund të bëhet duke përdorur studime rasti dhe diskutime grupore. Këto aktivitete mund të kërkojnë që fëmijët të analizojnë situata të ndryshme dhe të reflektojnë mbi ndjenjat dhe reagimet e të tjerëve. Përdorimi i studimeve të rasteve, ku fëmijët duhet të identifikojnë dhe të shprehin ndjenjat e karaktereve të caktuara, mund të ofrojë një mundësi për të vlerësuar aftësinë e tyre për të kuptuar dhe bashkëvepruar me ndjenjat e të tjerëve. Kjo gjithashtu mund të ndihmojë në matjen e progresit në zhvillimin e empatisë dhe aftësisë për të menaxhuar reagimet emocionale në situata sociale.

REFERENCAT

Collaborative for Academic, Social, and Emotional Learning (CASEL) – Frameworks and strategies for SEL implementation.

Durlak, J. A., Weissberg, R. P., Dymnicki, A. B., Taylor, R. D., and Schellinger, K. B. (2011). The Impact of Enhancing Students' Social and Emotional Learning: A Meta-Analysis of School-Based Universal Interventions. *Child. Dev.* 82, 405–432. doi:10.1111/j.1467-8624.2010.01564.

Jones, S. M., & Bouffard, S. M. (2012) – Strategies for embedding SEL into everyday teaching practices.

MASHTI (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Kosovë.

National Association for the Education of Young Children (NAEYC) – Guidelines on integrating SEL in early childhood settings.

Newman, J. & Dusenbury, L. (2015). Social and Emotional Learning (SEL): A Framework for Academic, Social, and Emotional Success. *Education, Psychology*

O'Conner, R., Feyter, J., Carr, A., Luo, J. L., and Romm, H. (2017). A Review of the Literature on Social and Emotional Learning for Students Ages 3–8: Characteristics of Successful Social and Emotional Learning Programs. Available at: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED572721.pdf>

Rathjen, D.P., & Foreyt, J.P. (2013). *Social Competence: Interventions for children and adults*. Pergamon General Psychology Series. Elsevier.

Schonert-Reichl, K. A., & Hymel, S. (2007) – Research on the role of educators in fostering SEL in the classroom.

Shehu, B.P. (2009). Factors correlating with social acceptance in preschool institutions. Master Thesis. University of Prishtine. Kosovo.

Shehu, B.P. (2019). Peer Acceptance In Early Childhood: Links To Socio-Economic Status And Social Competences. *Journal of Social Studies Education Research*, 10 (4).

Shehu, B.P. (2019). Social Competence and Attitude Towards School in Relation to Academic Achievements of Students in Kosovo. Doctoral Dissertation. All Dissertations. 2531.

Shehu, B.P. (2021). *Kompetenca sociale e fëmijëve: Teoritë, hulumtimet dhe intervenimet në fëmijëri të hershme*. Albas, Prishtine. Kosove.

Weissberg, R. P., & Cascarino, J. (2013) – SEL and Academics: Research Evidence and Practice Considerations. This outlines the impact of SEL on academic and behavioral outcomes.

Zins, J. E., Weissberg, R. P., Wang, M. C., & Walberg, H. J. (Eds.). (2004) – *Building Academic Success on Social and Emotional Learning: What Does the Research Say?* Focuses on the importance of SEL in educational settings.

Zins, J. E., Payton, J. W., Weissberg, R. P., & O'Brien, M. U. (2007). Social and emotional learning for successful school performance. In G. Matthews, M. Zeidner, & R. D. Roberts (Eds.), *The science of emotional intelligence: Knowns and unknowns* (pp. 376–395). Oxford University Press.

MJEDISE TË VETË-MJAFTUESHME PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME: DORACAK PËR MËSIMDHËNËS PËR VETËDIJESIMIN DHE VEPRIMIN E VETË-MJAFTUESHËM NË SHKOLLA

Matej Vošnjak, Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Edukimit, Slloveni

HYRJE

Zhvillimi i qëndrueshëm përqafon idenë e plotësimit të nevojave aktuale duke ruajtur aftësinë e brezave të ardhshëm për të bërë të njëjtën gjë. Ai përfshin trajtimin e një sërë shqetësimesh, nga mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i drejtësisë sociale deri te inkurajimi i progresit ekonomik dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore. Kjo qasje e shumëanshme kërkon një strategji tërësore dhe të integruar që njeh se si të gjithë këta faktorë janë të lidhur dhe synon të arrijë harmoninë mes tyre. Në mënyrë domethënëse, arritja e zhvillimit të qëndrueshëm përfshin përshtatjen e praktikave të ndërgjegjshme për mjedisin që i japin përparësi ruajtjes dhe restaurimit të burimeve natyrore (Arbuthnott, 2009; Elliot, 2012; Rogers et al., 2012; Vare & Scott 2007).

Përqafimi i vetë-mjaftueshmërisë është thelbësor për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm pasi nxit elasticitetin, rrit ekonomitë lokale, ruan mjedisin dhe fuqizon komunitetet. Këta faktorë thelbësorë janë themelorë për qëllimin kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili synon të ndërtojë një komunitet global më të drejtë, më elastik dhe miqësor ndaj mjedisit. Koncepti i vetë-mjaftueshmërisë përfshin aftësinë e një individi, komuniteti ose kombi për të përmbushur nevojat dhe detyrimet e tyre themelore në mënyrë të pavarur, pa mbështetje të madhe në ndihmën e jashtme.

Një entitet i vetë-mjaftueshëm përpigjet të gjenerojë, ofrojë ose arrijë të mira, shërbime dhe burime jetike nga brenda, duke minimizuar varësinë e tyre nga faktorët e jashtëm (Lamberton, 2005).

Vetëmjaftueshmëria në një kuptim më të gjerë përfshin a) Prodhimin e ushqimit (aftësinë për të rritur ose prodhuar sasi të mjaftueshme ushqimi në vend për të përmbushur nevojat ushqyese të popullsisë), b) Pavarësinë e Energjisë (gjenerimin ose shfrytëzimin e energjisë nga burimet lokale dhe të ripërtërishe për të zvogëluar varësinë nga furnizimet e jashtme të energjisë), c) Stabilitetin ekonomik (zhvillimi i një ekonomie të vetë-mjaftueshme që mund të mbajë veten pa mbështetje të madhe në tregjet ose burimet e jashtme), d) Menaxhimin e burimeve (menaxhimi dhe shfrytëzimi efikas i burimeve natyrore, reduktimi i mbetjeve dhe promovimi qëndrueshmëria), e) Aftësitë dhe njohuritë (posedimi i aftësive, njohurive dhe teknologjisë së nevojshme për të adresuar nevoja të ndryshme, nga bujqësia dhe prodhimi të kujdesi shëndetësor dhe arsimit) dhe f) Qëndrueshmërinë e komunitetit (ndërtimi i qëndrueshmërisë brenda komuniteteve për t'u bërë ballë sfidave, ndërprerjeve ose ndryshimeve në kushte të jashtme) (Beltran-Peña et al., 2020; Elliot, 2012; Rogers et al., 2012; Arbuthnott, 2009; Strawbridge & Strawbridge, 2010).

Konceptet e vetë-mjaftueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm janë të ndërthurura thellë, duke ndarë parime dhe objektiva të ngjashëm. Një aspekt themelor është reduktimi i varësisë nga burimet dhe inputet e jashtme, siç shihet në vetë-mjaftueshmërinë.

Kjo jo vetëm që përputhet me idenë e qëndrueshmërisë në minimizimin e përdorimit të burimeve të fundme, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin e elasticitetit dhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor. Për më tepër, vetë-mjaftueshmëria shpesh përfshin zhvillimin e ekonomive lokale dhe uljen e mbështetjes në tregjet e jashtme (Baer-Nawrocka & Sadowski, 2019; Beltran-Peña et al., 2020; Opoku et al., 2024).

Praktikimi i veprimeve të vetë-mjaftueshme në shkolla është i rëndësishëm për disa arsye, pasi përputhet me parimet e qëndrueshmërisë, edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenies së përgjithshme të nxënësve dhe komunitetit.

Në përgjithësi, posedimi i njohurive dhe aftësive në lidhje me vetë-mjaftueshmërinë i lejon mësimitdhënësit t'i mësojnë në mënyrë efektive nxënësit e tyre për parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Si rezultat, nxënësit janë më të përgatitur për të pasur ndikim pozitiv në krijimin e një të ardhmeje të qëndrueshme dhe elastike (Arbuthnott, 2009; Beltran-Peña et al., 2020; Opoku et al., 2024; Rogers et al., 2012). Në përmbledhje, praktikimi i veprimeve të vetë-mjaftueshme në shkolla jo vetëm që sjell dobi për mjedisin, por gjithashtu ofron përvoja të pasura arsimore, promovon qytetarinë e përgjegjshme dhe kontribuon në mirëqenien e nxënësve dhe komunitetit më të gjerë. Ai përputhet me një qasje gjithëpërfshirëse ndaj arsimit që përgatit nxënësit të jenë individë të ndërgjegjshëm ndaj mjedisit dhe të përgjegjshëm në shoqëri.

Vetëmjaftueshmëria, mjediset dhe aktivitetet kontribuojnë në qëndrueshmërinë mjedisore. Kjo ndihmon në reduktimin e ndikimit mjedisor në shkolla, duke reduktuar ndikimin e tij në mjedis. Ai gjithashtu u ofron nxënësve mundësi të vlefshme arsimore. Duke integruar praktikën e qëndrueshme në kurrikulë, nxënësit mund të mësojnë politikën mjedisore, ruajtjen dhe rëndësinë e të qenit qytetar i përgjegjshëm. Aktivitetet/mjediset e vetë-mjaftueshme (kopshtet e shkollave, programet e riciklimit të mbetjeve, ose programet e ruajtjes së energjisë etj.) ofrojnë përvoja praktike të të mësuarit për nxënësit dhe angazhojnë nxënësit në praktika të qëndrueshme dhe inkurajojnë të mësuarit me përvojë. Për më tepër, përmes përfshirjes së tyre, shkollat rrënojnë vlerat e përgjegjësisë dhe qytetarisë tek nxënësit e tyre. Nxënësit mësojnë të përqendrohen në ndikimin e tyre në mjedis dhe shoqëri, duke nxitur ndjenjën e përgjegjësisë sociale dhe etikës.

Si pjesë e një projekti në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Lubjanës, u hartua një doracak me titull "Mjedise të vetë-mjaftueshme për një të ardhme të qëndrueshme", qëllimi kryesor i të cilit është sensibilizimi i mësimitdhënësve të shkollave fillore, mësimitdhënësve të shkollave të mesme, fillore dhe nxënësve të shkollave të mesme dhe të gjithë të tjerëve të interesuar për zhvillimin e qëndrueshëm, për rëndësinë e vetë-mjaftueshmërisë si pjesë thelbësore e zhvillimit të qëndrueshëm. Doracakun trajton një çështje aktuale që diskutohet shpesh në literaturë, media dhe politikë në nivele të ndryshme hapësinore. Në të njëjtën kohë, trajton tema që janë të ndërthurura ngushtë me jetën tonë të përditshme. Doracakun ofron mundësinë për t'u marrë me këtë përmbajtje në mënyrë efektive në shkollë dhe në të njëjtën kohë për të kontribuar në një ndryshim në shprehitë e jetesës - në mënyrë që të jetohet sa më shumë të jetë e mundur dhe të jepet kontributi për një të ardhme të qëndrueshme në përputhje me të Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesë e rëndësishme e doracakut janë edhe aktivitetet ndërvepruese me kode QR që propozohen për të arritur objektiva të caktuara të zhvillimit të qëndrueshëm që janë të lidhura ngushtë me temën e vetë-mjaftueshmërisë. Aktivitetet e paraqitura lidhen drejtpërdrejt me temën e vetë-mjaftueshmërisë së qëndrueshme dhe mund të realizohen nga kushdo.

Vetëmjaftueshmëria e qëndrueshme është një mënyrë jetese dhe është e drejtë të paraqitet si vlerë për të gjithë nxënësit, disa herë gjatë procesit të shkollimit të tyre.



Para jush është doracaku "Mjedise të vetë-mjaftueshme për të ardhme të qëndrueshme", i cili u drejtohet të gjithë entuziastëve të zhvillimit të qëndrueshëm, vetë-mjaftueshmërisë dhe një mënyre jetese të qëndrueshme. Doracaku mund të shërbejë si mbështetje për edukatorët, mësimdhënësit, prindërit dhe këdo tjetër që dëshiron të mësojë për vetë-mjaftueshmërinë dhe të jetojë në mënyrë të vetë-mjaftueshme dhe të veprojë në përputhje me udhëzimet dhe qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Ai synon të promovojë vetë-mjaftueshmërinë si një mënyrë jetese e qëndrueshme, apelon për promovimin e vetë-mjaftueshmërisë dhe për sfidën e zgjidhjes së aktiviteteve të përshkruara në doracak.

Në doracakun aktual kemi paraqitur vetë-mjaftueshmërinë si pjesë e rëndësishme e një mënyre të qëndrueshme jetese dhe rëndësinë e vetë-mjaftueshmërisë, dhe shembuj të dhënë të mjediseve të vetë-mjaftueshme dhe aktivitete që lidhen me këtë temë, duke bërë kështu sugjerime që kontribuojnë për arritjen e qëllimeve të Agjendës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm lidhur me vetë-mjaftueshmërinë.

Me përmbajtjet dhe aktivitetet e përshkruara në doracak, synojmë të arrihet vetëdijesim më i madh për mjediset e vetë-mjaftueshme, biodiversitetin konservimin, dobisë e ushqimit të kultivuar në shtëpi, reduktimin e ndikimit në mjedis, natyrën, mbrojtjen e burimeve natyrore strategjike, etj.

Paçi fat me stilin tuaj të qëndrueshëm të jetesës.



TË NJOFTOHEMI	1	<p>ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM 5</p> <p>Agjenda 2030..... 6</p> <p>Aktivitetet 9</p>
PRODHO	2	<p>MJEDISE TË VETËMJAFTUESHME 10</p> <p>Krijimi i kopshtit 11</p> <p>Pemë dhe perime të kultivuara në shtëpi 12</p> <p>Pemë të shijshme nga kopshti shtëpiak 14</p> <p>Kopsht barishtesh 15</p> <p>Barishtet: Përfitimet dhe Përdorimet 16</p> <p>Filizat 17</p> <p>Vegjetacion i vogël 18</p> <p>Rritni kërpudha në shtëpi 19</p> <p>Gardhi i gjelbër 20</p> <p>Eksperiment: Si mjediset e vetë-mjaftueshme kontribuojnë për një atmosferë më të mirë 21</p> <p>Kompostimi 22</p> <p>Organizmat e kopshtit 23</p>
NGRËNIA	3	<p>TË HAMË TË QËNDRUESHËM 24</p> <p>Ku mund të blej në afërsi? 26</p> <p>Ripërdorimi i ushqimit 28</p> <p>Siguria ushqimore 29</p> <p>Mbeturinat ushqimore 30</p> <p>Të ngrënit qëndrueshëm 31</p>
MËSO MË SHUMË	4	<p>REFERENCAT 32</p> <p>Ku mund të blej në afërsi? 26</p>

TË NJOFTOHEMI

1. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Zhvillimi i qëndrueshëm ka të bëjë me një të ardhme më të mirë në të cilën njerëzit do të jetojnë në një ekuilibër midis suksesit ekonomik, ekologjik përgjegjësish dhe drejtësisë sociale. Duhet të jemi të vetëdijshëm për kufizimet e natyrës për burimet botërore dhe të veprojmë në kuadër të qëndrueshmërisë mjedisore dhe drejtësisë ndër breza.

Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon zgjidhje të reja për të adresuar problemet e qyteteve, me një mjedis të vetë-mjaftueshëm si praktikë e shkëlqyer që ka shumë efekte pozitive tek individët, shoqëria dhe mjedisi, duke kontribuar kështu ndjeshëm në qëndrueshmëri më të madhe në qytete.

Të krijojmë më shumë hapësira të gjelbra në qytete

... dhe kështu përmirësojmë cilësinë e ajrit

Të rrisim vetëdijësimin për rëndësinë e një mjedisi të vetë-mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm

SHKOLLA

Përdorni metoda të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe rrisni vetë-mjaftueshmërinë ushqimore

Le të reduktojmë mbeturinat ushqimore duke i ripërdorur ato.

Le të punojmë së bashku për të ruajtur jetën në ujë dhe në tokë.

Le të prodhojmë plehra miqësore për mjedisin përmes kompostimit.

5

GET TO KNOW

AGENDA 2030 FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT

2) ZERO HUNGER

The goal is to end hunger by 2030. It is predicted that up to 600 million people will go hungry in 2030 if we do not take action now. Food prices are rising and will remain high due to conflicts, climate disasters and rising standards.

In Europe, 131 kg of food per inhabitant is thrown away every year. People who used to grow food are leaving the country side to make small profits.

The aim is to increase the yield of agriculture and small producers and ensure sustainable food production. It also strives for a more equal distribution of food in the world.

HOW CAN I CONTRIBUTE?

Support local producers (buy directly from the farmer, choose homemade local products at the market or in the store). Buy quality food and be sustainable with it - do not throw food away, but try to use as much as possible at home before you go shopping again. Start gardening and grow your own food.

LEARN MORE ↓



4) QUALITY EDUCATION

The goal is free and compulsory education in primary and secondary schools. It stands for equal access to quality education for all genders and access to post-secondary education for all. Educated people are the ones who will make a major contribution to achieving the other Sustainable Development Goals. By raising awareness in schools of the importance of a self-sufficient environment, we can make an important contribution to this and other goals.

HOW CAN I CONTRIBUTE?

- Raise awareness of the importance of a self-sufficient environment for a sustainable future with the help of present manual.
- Help students with their homework or instructions.
- Help collect school supplies for the socially disadvantaged.

LEARN MORE ↓



11) SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES

The goal is to create cities and settlements that are safe and adapted for all inhabitants and at the same time sustainable. More than half of people live in cities, but about 1.1 billion of them live in shanty towns (a number that will increase in the coming years). Cities cannot keep pace with the ever-increasing urbanization that requires more and more housing, infrastructure and services. As a result, cities are getting bigger, air pollution is increasing and public green spaces are shrinking.

WHAT ARE THE PROBLEMS? Inequality, intolerance and insecurity among residents; pollution that threatens everyone's health (and directly the economy); traffic congestion; the greenhouse effect.

WHY SUSTAINABLE CITIES? To offer residents a high quality of life and protect the environment.

WHAT DOES A SUSTAINABLE CITY INVOLVE? Well-organized public transport (environmentally friendly fuels, e.g. methane, hydrogen, electricity...), public green areas (contribute to air quality), separate waste collection, accessible housing, protected natural and cultural heritage. A sustainable city has buildings that use renewable energy sources (reducing environmental impact).

HOW CAN I CONTRIBUTE?

- Support local entrepreneurs.
- Ride your bike or use public transportation.
- Take care of the public space - water the green areas, organize a cleaning campaign, etc.

LEARN MORE ↓



12) RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION

The goal is to ensure a sustainable way of producing and consuming. The total amount of all waste is slowly decreasing, which improves comparability between countries. The problem is the amount of food waste, which is increasing per inhabitant. Food waste includes all raw or processed food and its residues that are lost or thrown away during the production, distribution, sale and provision of food services and in households. One problem that has long been highlighted by the public is the average carbon dioxide emissions of cars. Although this is declining, the numbers are still too high.

HOW CAN I CONTRIBUTE? Follow tips of present manual in the "Let's eat sustainably" chapter or scan QR code.

LEARN MORE ↓



13) CLIMATE ACTION

The goal highlights the extent of man-made greenhouse gas emissions. In 2009, an agreement was reached at the climate conference in Copenhagen on voluntary financial and technical support from industrialised countries for developing countries to mitigate and adapt to climate change. The agreement was reaffirmed in the Paris Climate Agreement in 2015.

HOW CAN I CONTRIBUTE?

- Walk short distances, use a bicycle or public transport.
- Switch to renewable energy (solar panels on your roof, use wind energy...).
- Reduce, reuse and recycle waste. Use reusable bags.
- Use both sides of paper when writing and printing; buy seasonal and locally produced food.
- Turn off the lights when you leave the room; use energy-saving LED lights.

Remember that even small changes in your daily life can make a difference. Every effort counts and collective action is key in the fight against climate change.

LEARN MORE ↓



14) LIFE BELOW WATER

The goal is to maintain the proportion of inland and marine bathing waters that are of excellent quality according to the criteria of the Bathing Water Directive or the Regulation on the management of bathing water Quality.

The amount of water on Earth is a key factor in ensuring that our planet remains habitable and that life as we know it is possible. Water plays several essential roles in the Earth's natural systems, so maintaining water quantity and quality is crucial for: supporting life, climate stability, weather patterns, biodiversity and agriculture.

The conservation and sustainable management of water resources is critical to the continued functioning of these ecological and social systems. As the human population grows and the effects of climate change become more pronounced, the protection and conservation of water resources becomes increasingly urgent for the preservation of life on earth.

HOW CAN I CONTRIBUTE? Scan the QR code.

LEARN MORE ↓



15) LIFE ON LAND

The goal advocates the conservation of terrestrial ecosystems and estimates that the proportion of the country's total land area covered by forests has remained roughly the same in recent years. Despite the global destruction of forests, the area of land designated under Natura 2000 has remained relatively constant in recent years. It is important to maintain the balance between forested land, agricultural land and fertile soil.

Why is it important to maintain the proportion of forested land? Because in this way we preserve biodiversity, which also has an impact on mitigating the effects of climate change and on maintaining and improving air quality.

Why is it important to maintain the proportion of agricultural land? Because in this way we contribute to food self-sufficiency and maintain the economic benefits of the land.

Why is it important to maintain the fertility of the soil? Because in this way we increase and maintain yields, supply plants with nutrients and support diverse and active biotic communities.

HOW CAN I CONTRIBUTE? Scan the QR code.

LEARN MORE ↓



GET TO KNOW

ACTIVITIES THAT CONTRIBUTE TO ACHIEVING THE GOALS OF THE 2030 AGENDA AT GLOBAL AND REGIONAL LEVEL

**GOAL 2: ZERO HUNGER**

- Find out how much food is produced at home in your country.
- Buy eggs, milk or other food from a local farmer.
- Grow a type of fruit or vegetable in your own garden.

ACTIVITIES ↓

**GOAL 4: QUALITY EDUCATION**

Read the present manual and perform at least five activities.

ACTIVITIES ↓

**GOAL 11: SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES**

- Use the Carbon Footprint Calculator (access by scanning the QR code) to calculate how many planet Earths humanity would need if everyone would live like you.

CALCULATE ↓ ACTIVITIES

**GOAL 12: RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION**

- Gardening and composting
- Create a small garden and a compost garbage can.
- Raise awareness of locally produced food
- Visit a farmers' market or farm near you and find out about locally grown food.
- Reuse food waste.

ACTIVITIES ↓

**GOAL 14: LIFE BELOW WATER****• Save water**

1. Collect rainwater and use it to water the garden.
2. Place houseplants outside during the rain so that they are watered by the rain.

ACTIVITIES ↓

**GOAL 15: LIFE ON LAND**

- Research which organisms are found in the garden.
- Invite an environmental NGO that carries out animal and plant population counts to your school (or organize a visit to them) and take part in a count of a particular animal or plant species.

ACTIVITIES ↓



PRODUCE

2. SELF-SUFFICIENT ENVIRONMENTS

A **self-sufficient environment** is one in which an individual grows their own food, thereby reducing dependence on purchased or imported food.

Climate change poses a serious threat to global food production in the future. More than half of the world's population now lives in cities, where a self-sufficient environment can play a major role. Today's balanced diet guidelines encourage the consumption of locally and seasonally produced food. **Self-sufficient environments in cities** help to ensure food security, reduce the environmental and carbon footprint (the sum of all greenhouse gas emissions caused directly or indirectly by an individual, country, event or product) and education, and support many ecosystem services that increase the quality of the living environment, preserve nature and biodiversity, contribute to better physical and mental health, and provide space for relaxation and recreation, which is in line with many of the Sustainable Development Goals of the 2030 Agenda.

CALCULATE YOUR CARBON FOOTPRINT



CARBON FOOTPRINT

7 POINTS FOR THE REDUCTION OF THE CARBON FOOTPRINT

1. Proper waste separation
2. Recycling and reuse
3. Prevention of waste generation
4. Economical water consumption
5. Economical use of energy
6. Sustainable mobility
7. Sustainable consumption

SCAN THE QR-CODE TO REDUCE YOUR CARBON FOOTPRINT



Check how sustainably you live



REFERENCAT

Arbuthnott, K. D. (2009). Education for sustainable development beyond attitude change. *International Journal of Sustainability in Higher Education*.

Baer-Nawrocka, A., & Sadowski, A. (2019). Food security and food self-sufficiency around the world: A typology of countries. *PloS one*, 14(3), e0213448.

Beltran-Peña, A., Rosa, L., & D'Odorico, P. (2020). Global food self-sufficiency in the 21st century under sustainable intensification of agriculture. *Environmental Research Letters*, 15(9), 095004.

Elliott, J. (2012). *An introduction to sustainable development*. Routledge.
Lamberton, G. (2005). Sustainable sufficiency—an internally consistent version of sustainability. *Sustainable development*, 13(1), 53-68.

Opoku, A., Duff, A., Yahia, M. W., & Ekung, S. (2024). Utilisation of green urban space for food sufficiency and the realisation of the sustainable development goals—UK stakeholders perspective. *Geography and Sustainability*, 5(1), 13-18.

Rogers, P. P., Jalal, K. F., & Boyd, J. A. (2012). *An introduction to sustainable development*. Earthscan.

Strawbridge, D., & Strawbridge, J. (2010). *Practical Self Sufficiency: The Complete Guide to Sustainable Living*. Dorling Kindersley Ltd.

Vare, P., & Scott, W. (2007). Learning for a Change: Exploring the Relationship Between Education and Sustainable Development. *Journal of Education for Sustainable Development*, 1(2), 191–198.

TEORIA E NDRYSHIMIT E BAZUAR NË VLERA

Fatlume Berisha, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

Sipas Halstead (2005), "termi vlerë përdoret për t'iu referuar parimeve dhe bindjeve themelore, idealeve, standardeve ose qëndrimeve të jetës që veprojnë si udhërrëfyes të përgjithshëm për sjelljen ose si pika referimi në vendimmarrje ose vlerësimin e besimeve ose veprime dhe që janë të lidhura ngushtë me integritetin personal dhe identitetin personal" (f.13). Në lidhje me përkufizimin e vlerës sipas Halstead (2005), Gaikwad (2004) shtjellon marrëdhënien midis vlerës dhe veprimeve. Gaikwad e bazoi shpjegimin e tij duke përdorur një model piramide me katër shtresa nga Mariani (1999) (Figura 1) si një ilustrim se si vlerat dhe sistemi ynë i besimeve kanë ndikim në jetën tonë, rrjedhimisht, në veprimet tona. Modeli tregon se si besimet tona i formësojnë qëndrimet tona.

Qëndrimet tona formësojnë gjykimet/vendimet tona, duke drejtuar sjelljen dhe veprimet tona. Ajo që ne vëzhgojmë në botë është pasoja përfundimtare e vendimeve tona, ndërsa qëndrimet dhe besimet tona formësojnë shtigjet tona për të arritur deri atje. Në këtë mënyrë, ne fitojmë një kuptim më praktik të rëndësisë së vlerës.




Figura 1. Marrëdhënia ndërmjet besimeve, qëndrimeve, vendimeve dhe veprimeve (Mariani, 1999).

Profesor Emeritus, David Perkins, nga Universiteti i Harvardit, shtjellon çështjen "Çfarë do të thotë të jesh i zgjuar?" (The Brainwaves Video Antology, 2018). Perkins diskuton se si një nivel i lartë i inteligjencës (IQ) nuk do të thotë se jeni i zgjuar dhe se të jesh i zgjuar nënkupton të kesh disa predispozita që janë pjesë e karakterit, të jeni të gjithanshëm, spirituoze, performues dhe intuitiv. Nivelet e IQ-së së studentëve janë kryesisht të lidhura me zhvillimin e problemeve të vlerave dhe një zgjidhje është rigjallërimi i edukimit të bazuar në vlerë, i cili shpesh neglizhohet në praktikën arsimore bashkëkohore (Supriadi et al., 2022). Morali, qytetaria, karakteri, edukimi etik dhe të tjera janë të gjitha nënbashkësi të idesë më të madhe të edukimit për vlera (Taylor, 2006; Thornberg, 2016; Johansson et al., 2016).

Hawkes, themeluesi i Edukimit të Bazuar në Vlera, thotë se: "Bota jonë ka kaq shumë nevojë për shpresë. Edukimi i bazuar në vlera po sjell këtë shpresë, duke krijuar një lëvizje transformuese që ka potencialin për të transformuar arsimin dhe shoqërinë, në mënyrë që ne të mund të jetojmë në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin, duke siguruar qëndrueshmërinë e planetit tonë" (Values-based Education [VbE], 2023). Megjithatë, do të duhet të zhvillohen baza specifike të mësimdhënies dhe të nxënësve që nxënësit të përfitojnë sa më shumë nga qasja e edukimit për vlera, shtjellon Hawkes (2009). Ajo që e bën të mundur këtë është një mjedis i favorshëm i të nxënësve në klasë, mjedis pozitiv, i qetë dhe gjithëpërfshirës, me ndjesi të barazisë. Kjo do t'i ndihmonte studentët të përfitonin sa më shumë mbi edukimin e vlerave të tyre. U mendua thelbësisht që çdo strategji e përdorur për menaxhimin e klasës duhet të pasqyrojë vlerat që u mësohen dhe kërkohen nxënësve (Hawkes, 2009). Për më tepër, ndërsa nxënësit shohin se kontributet e tyre vlerësohen gjithmonë, ata ndjehen më të relaksuar dhe bëhen më të hapur për veten dhe përvojat e tyre. Nxënësit do të përgjigjen shpejt nëse mësimdhënësi demonstroi një model vlerash pasi vlerat shpesh "kapen/ modelohen" (Hawkes, 2009).

Toomey (2009) "propozoi që edukimi për vlera ishte lidhja që mungonte në mësimdhënien cilësore" (f.141). Lidhja ndërmjet vlerave dhe mësimdhënies cilësore (dhe aspektit ndërlidhës, të nxënësve cilësor) ka pasojat për trajnimin dhe zhvillimin e mësimdhënësve (Toomey, 2009). Toomey e përshkruan lidhjen midis edukimit për vlera dhe mësimdhënies cilësore si një "spirale të dyfishtë" gjenetike (fq. 143), ku edukimi për vlera shërben si gjysma e spirales së përfaqësuar nga mësimdhënien cilësore në gjysmën tjetër (Figura 2). Sipas Toomey (2009), edukimi për vlera mund të ripërcaktojë ndjeshëm rolin e mësimdhënies dhe ndikimin e shkollës në shoqëri.





Figura 2. "Spiralja e dyfishtë" e edukimit për vlera dhe mësimdhënies cilësore (Toomey, 2009, f. 143).

Përfshirja e edukimit për vlera në praktikën arsimore nuk mund të përmirësojë vetëm zhvillimin e kompetencave të studentëve, por gjithashtu t'i vendosë nxënësit të jenë qytetarë global, të suksesshëm, të sigurt dhe të përgjegjshëm në të ardhmen (Read, 2018). Përveç kësaj, përfitimet e edukimit të bazuar në vlera nuk janë komponentë automatikisht të pranueshëm në praktikën arsimore. Sipas Toomey (2009), edukimi për vlera nuk mund të konsiderohet i marginalizuar. Vlerat duhet të bëhen një komponentë thelbësore e kurrikulës, në mënyrë që puna transformuese e mësimdhënësve dhe shkollave të ketë ndikimin maksimal në rezultatet e nxënësve për sa i përket thellësisë intelektuale, kompetencës së komunikimit, kapaciteteve për reflektim, vetë-menaxhimit dhe, më e rëndësishmja, vetë-njohjen.

Kur një shkollë vendos vlerat në qendër të punës së saj dhe i jeton në mënyrë aktive ato vlera, sjellja e nxënësve dhe e mësimdhënësve ndryshon dhe në mënyrë progresive çon në mësimdhënie dhe të nxënësve cilësor. Dinamika e klasës ndryshon kur mësimdhënësit dhe nxënësit me vetëdije përpiqen të jenë të respektueshëm, të ndershëm, tolerantë etj. Ai ndryshon lidhjet personale dhe ndërpersonale në shkollë. Mësimdhënia dhe të nxënësve cilësor vijnë natyrshëm kur parimet si respekti, toleranca, përpjekja për më të mirën dhe të tjera i japin formë aktiviteteve në klasë dhe ku aktiviteti në klasë është projektuar për të vënë bazën në praktikën e edukimit për vlera (Toomey, 2009). Pra, si mund t'i angazhojmë nxënësit në edukimin për vlera?

Teoria e ndryshimit të bazuar në vlera (Values-based Theory of Change (VTC)) mund të përdoret për të hartuar një sërë kriteresh mësimore dhe veprimesh për vlera specifike, që të krijoj kushtet për angazhimin e nxënësve në edukimin e bazuar në vlera. Ka kaç shumë vlera që janë standarde për arsimin cilësor, por për qëllimin e këtij shkrimi unë do të zgjedh vlerën e mëposhtme: "Të qenurit Rezilient".

Diagrami i Teorisë së ndryshimit të bazuar në vlera (VTC):



VLERA: "Rezilient" – që e merr vetën shpejtë

Të qenit rezilient (*Resilient*) është kapaciteti për të mbijetuar, për t'u zhvilluar dhe për t'u bërë ballë rrethanave ose pengesave të pafavorshme" (Rouse, 2001). Pooley dhe Cohen (2010) e përkufizojnë reziliencën si "Potenciali për të shfaqur shkathtësi duke përdorur burimet e disponueshme të brendshme dhe të jashtme në përgjigje të sfidave të ndryshme kontekstuale dhe zhvillimore".

Duhet të theksohet se të qenurit rezilient, ndryshon midis moshave, fazave të zhvillimit dhe situatave, por nuk është diçka me të cilën kemi lindur; në vend të kësaj, është një proces në zhvillim që ndikohet nga përvojat tona. Kjo tregon se të qenurit rezilient mund të zhvillohet dhe të mësohet. Për shembull, edukimi i nxënësve për marrjen e vendimeve konstruktive në fillimet e jetës dhe inkurajimi i tyre për ta bërë këtë mund të rrisë reziliencën dhe qëndrueshmërinë e tyre. Kjo arrihet duke ofruar skenarë të përsëritur për nxënësit dhe metoda efektive të përballimit.

KRITERET (Education Executive, 2019):

- Përqafoni ndryshimin - mësoni të merreni pozitivisht me ndryshimet, dështimet dhe sfidat;
- Nxënës gjatë gjithë jetës - mësoni aftësi të reja, fitoni njohuri të reja dhe përdorni ato në një mjedis që ndryshon, një botë që ndryshon;
- Merr përgjegjësinë - Merr përgjegjësinë për mësimin dhe zhvillimin tënd. Zhvilloni një mentalitet pozitiv si optimizmi, synimi për përsosmëri, etikë të fortë pune, vetë-mbështetje, vetërregullim, shkathtësi, këmbëngulje dhe përgjegjësi;
- Gjeneroni qëllimin - Shqyrtoni pengesat në kontekstin e një "fotografie" më të madhe;
- Vetë Identiteti - Dijeni se kush jeni, pavarësisht nga detyra juaj. Vlerësoni të mësuarit mbi përfundimin e detyrës;
- Ndërtoni marrëdhënie - Lidhuni me kolegët, shkollën, në internet dhe me komunitetin për të zhvilluar dhe ushqyer një rrjet të gjerë marrëdhëniesh ndërpersonale dhe profesionale. Zhvilloni marrëdhënie/aftësi sociale dhe dëgjoni dhe mbështesni njëri-tjetrin;
- Reflektoni - Promovoni mësimin, pikëpamjet e reja dhe vetëdijen kur reflektoni;
- Zhvendosja e aftësive - Zhvendosni këndvështrimin tuaj në pikat tuaja të forta, interesat, talentet dhe aftësitë tuaja. Ndërtoni fuqitë tuaja, merrni rreziqe dhe zhvilloni talente dhe interesa të reja.

VEPRIMET:

- Ndhmoni nxënësit të identifikojnë pikat e tyre të forta dhe të shikojnë mundësitë se si mund t'i përdorin ato;
- Mbështetni nxënësit të ndërtojnë një plan rezilient. Ndhmojini të identifikojnë gjëra të ndryshme që i bëjnë ata rezilient dhe të qëndrueshëm;
- Jepni nxënësve komente të rregullta për të theksuar zhvillimin e tyre dhe për t'i ndihmuar ata të rriten dhe të zhvillohen më tej;
- Siguroni skenarë për nxënësit ku ata duhet të mësojnë të zgjidhin problemet;
- Modeloni reziliencë, qëndrueshmëri dhe vlera në klasë;
- Ndhmoni nxënësit të lidhin mësimin e tyre me përvojat ose qëllimet e tyre personale;
- Mësojuni nxënësve strategji për t'i ndihmuar ata të bëhen nxënës rezilientë dhe adaptues.

Të qenurit rezilient për mua është një vlerë e gjallë dhe e jetuar, dhe kriteret e mësipërme janë hapa që më ndihmuan të bëhem rezilient. Në të njëjtën kohë, veprimet janë vetëm modele strategjish për edukatorët dhe mësimdhënësit për të stimuluar të qenit rezilient. Përmes këtij shkrimi, ju bëj thirrje mësimdhënësve dhe edukatorëve të veçojnë vlerat të cilat ata mendojnë se janë të domosdoshme për integrim në edukimin e bazuar në vlera, që të zhvillojmë qytetarë të suksesshëm, të sigurtë dhe të përgjegjshëm në aspektin global.



REFERENCAT

- Gaikwad, P. (2004). Curriculum, pedagogy, and values: Revealing the invisible. *International Forum Journal*, 7(2), 5-16.
- Education Executive. (2019, 01 24). *Eight steps to help you become more resilient*. Retrieved February 20, 2023 from Education Executive: <https://edexec.co.uk/eight-steps-to-help-you-become-more-resilient/>
- Halstead, M. (2005). Values and values education in schools. In *Values in education and education in values* (pp. 3-14). Routledge.
- Hawkes, N. (2009). Values and quality teaching at West Kidlington primary school. In T. Lovat, & R. Toomey, *Values education and quality teaching: The double helix effect* (pp. 105-120). Springer
- Johansson, E., Emilson, A., Röthle, M., Puroila, A. M., Broström, S., & Einarsdóttir, J. (2016). Individual and collective rights expressed in educator and child interactions in Nordic preschools. *International Journal of Early Childhood*, 48, 209–224.
- Mariani, L. (1999, March 18-20). *Probing the hidden curriculum: Teachers' and students beliefs and attitudes*. Retrieved February, 2023 from The British Council 18th National Conference for Teachers of English: <http://www.learningpaths.org/papers/paperbeliefs.htm>
- Pooley, J. A., & Cohen, L. (2010). Resilience: A definition in context. *Australian Community Psychologist*, 22(1), 30-37.
- Read, C. (2018). Values education for children: issues, challenges and solutions. *The newsletter of the IATEFL Young Learners and Teenagers Special Interest Group*. TEYL WorldWide, Issue 1.
- Rouse, K. G. (2001). Resilient students' goals and motivation. *Journal of adolescence*, 24(4), 461-472.
- Supriadi, U., Supriyadi, T., Abdussalam, A., & Rahman, A. A. (2022). A Decade of Value Education Model: A Bibliometric Study of Scopus Database in 2011-2020. *European Journal of Educational Research*, 11(1), 557-571.
- Taylor, M. (2006). The development of values through the school curriculum. In R. M. Cheng, J. K. Lee, & L. K. Lo, *Values education for citizens in the new century* (pp. 107–131). Sha Tin: The Chinese University Press.
- The Brainwaves Video Anthology. (2018, June 21). *David Perkins: What Does it Mean to be Smart?* [Video]. YouTube. From <https://www.youtube.com/watch?v=esZdD-xRhTU>
- Thornberg, R. (2016). Values Education in Nordic Preschools: A Commentary. *International Journal of Early Childhood*, 48(2), 241–257.
- Toomey, R. (2009). The Double Helix and Its Implications for the Professional Lifelong Learning of Teachers. In T. Lovat, & R. Toomey, *Values Education and Quality Teaching. The Double Helix Effect* (pp. 141-150). Springer.
- Values-Based Education [VbE]. (2023, February). *Values-Based Education*. Retrieved February, 2023 from <https://www.valuesbasededucation.com/>

AKTIVITETET E BAZUARA NË KËRKIME NË LËNDËN E KIMISË NË NJË MJEDIS ARSIMOR JOFORMAL – NJOHURI NGA PROJEKTI SLOVEN DISSI

Miha Slapničar, Luka Vinko, Luka Ribič dhe Iztok Devetak
Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Edukimit, Slloveni
BEC Ljubljana, Shkolla e mesme e lartë e përgjithshme
dhe shkolla e teknikëve veterinarë, Lubjanë

RRETH PROJEKTIT DISSI

Diversiteti në shkencë drejt përfshirjes sociale (DiSSI) – edukimi joformal në shkencë për diversitetin e nxënësve ishte një projekt ndërkombëtar Erasmus+ me partnerë nga Gjermania, Irlanda, Mbretëria e Bashkuar, Maqedonia e Veriut dhe Sllovenia.

Projekti u financua nga Bashkimi Evropian dhe zgjati nga janari 2020 deri në korrik 2023. Qëllimi i projektit DiSSI ka buruar nga fakti se mësimdhënia gjithëpërfshirëse në lëndët shkencore zakonisht fokusohet vetëm në një dimension të diversitetit në të njëjtën kohë, p.sh., me kujdesin vetëm për nxënësit me probleme gjuhësore ose thjesht për ata të talentuar. Mësimi shpesh nuk merr parasysh se diversiteti është në thelb shumëdimensional, gjë që mund të çojë në praktika pedagogjike me rezultate të kufizuara. Prandaj, qëllimi i këtij projekti ishte zhvillimi i strategjive arsimore për nxënës të ndryshëm në fushën e kimit në një mjedis arsimor joformal që trajton në të njëjtën kohë sa më shumë që të jetë e mundur katër dimensione të diversitetit të nxënësve:

1. ata me aftësi më të ulëta gjuhësore për komunikim efektiv në gjuhën që mbizotëron në shoqëri,
2. ata që vijnë nga staturë më të ulëta socio-ekonomike,
3. ata që i përkasin një mjedisi etnik ose kulturor që është i ndryshëm nga shumica e shoqërisë, dhe
4. ata që konsiderohen të talentuar në shkencë ose kimi.

Këto dimensione janë paraqitur në Figurën 1.



Figura 1: Dimensionet e projektit DiSSI.

Me qëllimin e angazhimit efektiv të grupeve të nxënësve të listuar në mësimin shkencor, projekti zhvilloi metoda dhe shembuj të praktikave më të mira për të ndihmuar mësimdhënësit e kimisë që të mësojnë grupe heterogjene nxënësish në shkollën e mesme të ulët dhe të lartë. Duke vepruar kështu, të gjithë partnerët e DiSSI ndoqën të njëjtat faza të projektit (Figura 2).




Figura 2: Fazat e projektit DiSSI.

AKTIVITETE MËSIMORE JOFORMALE DISSI PËR NXËNËSIT E TALENTUAR

Puna e grupit sloven DiSSI (<https://dissislovenia.splet.arnes.si/>) u fokusua tek nxënësit e talentuar në shkencë, veçanërisht në kimi, në fazën e parë të zbatimit të seminareve DiSSI në mjedisin arsimor joformal. Nxënësit e talentuar morën njohuritë për kiminë jashtë shkollës, në Qendrën KemikUm (<https://www.pef.uni-lj.si/raziskovanje-in-umetnost/center-kemikum/>), e cila funksionon me sukses në Universitetin e Lubjanës, Fakulteti i Edukimit që nga viti 2017.

Nxënësit e talentuar në kimi tregojnë nivel të lartë gatishmërie dhe interesi për të mësuar përmbajtje të reja të kimit. Në mësimin e kësaj përmbajtjeje, ata tregojnë aftësi të mira përqendrimi dhe pjekuri metakognitive. Ata përdorin terma që lidhen me kiminë për të përshkruar konceptet dhe fenomenet kimike, dhe në këtë kuptim, kanë një fjalor të gjerë natyror. Kuptimi i koncepteve kimike nga nxënësit e talentuar në kimi është i shpejtë, i thellë dhe me cilësi të lartë dhe nuk përfshin koncepte jo të plota ose të gabuara. Ata janë të vetmit që janë në gjendje t'i dallojnë këto në mesin bashkëmoshatarëve gjatë një diskutimi dhe t'i vënë në dukje ato (Taber, 2010).

Të talentuarit në kimi mund të lidhin lehtësisht koncepte të reja me ato ekzistuese dhe me fenomenin kimik që ata përshkruajnë. Ata janë në gjendje të mendojnë përpara dhe të bëjnë kërcime mendore në nivele të ndërmjetme dhe, për ta, më pak të rëndësishme në ndërtimin e të kuptuarit të një koncepti. Ata e kuptojnë shpejt drejtimin në të cilin duhet të shkojë hulumtimi i një fenomeni kimik dhe përcaktojnë paraprakisht rezultatet e kërkimit. Kompetencat e të talentuarve në kimi shtrihen në aftësinë për të krijuar modele kimike dhe matematikore të një dukurie të caktuar dhe për të krijuar shpjegime krijuese dhe të vlefshme të dukurive kimike. Ata sfidohen nga problemet kimike të vendosura në kontekstin e situatave të jetës reale dhe ata i lidhin rezultatet e problemeve të zgjidhura kimike me kontekstin e ri pa vështirësi. Ata janë të aftë për të menduar në mënyrë abstrakte, gjë që i ndihmon ata të identifikojnë modele në të dhëna ku lidhjet midis tyre nuk janë qartë të dukshme. Mbi këtë bazë, ata propozojnë disa strategji alternative për kontrollimin e parashikimeve ose mbledhjen e të dhënave gjatë punës eksperimentale (Gilbert dhe Newberry, 2007).

Nxënësit e talentuar pëlqejnë të vendosin hipoteza dhe të manipulojnë variabla në kërkimin eksperimental. Ata punojnë me këmbëngulje, kryejnë aktivitetet e tyre dhe krijojnë një produkt me cilësi të lartë. Pas përfundimit të një punimi kërkimor mbi një përmbajtje të caktuar kimike, ata janë në gjendje të krijojnë një pasqyrë të përmbajtjes, të reflektojnë mbi të menduarit dhe të mësuarit e tyre ndërsa përpiqen të kuptojnë konceptet kimike në thellësi (Benny dhe Blonder, 2018).

Për këto arsye, aktivitetet specifike mësimore të zhvilluara si për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta ashtu edhe për ato të larta përfshijnë modulet e mëposhtme të zhvilluara të mësimi DiSSI:

- 1) "Shkenca e mjekësisë ligjore",
- 2) "Kimia e mjedisit - uji",
- 3) "Kimia e gjelbër e së ardhmes",
- 4) "Substancat biologjikisht aktive në spec" dhe
- 5) "Kimia e mjaltit".

Të gjitha modulet mësimore DiSSI bazohen në parimin e qasjes së të mësuarit të bazuar në kërkim (IBL), e cila është dëshmuar të jetë po aq efektive në mësimdhënien dhe mësimnxënien e kimisë për nxënësit e talentuar si për të tjerët, por me disa përshtatje në qasjen e mësimnxënies. Në fazën e parë të këtij projekti, u zhvilluan disa module mësimi DiSSI. Në fazën e dytë, modulet mësimore DiSSI u përshtatën duke përdorur disa metoda të tjera të zhvilluara nga partnerët ndërkombëtarë në projekt.

Në seksionin e mëposhtëm të këtij punimi, moduli mësimor DiSSI, i cili u fokusua në përmbajtjen e mjekësisë ligjore, është paraqitur më në hollësi. Nxënësit që merrnin pjesë në modulën "Shkenca e Mjekësisë Ligjore" të DiSSI duhej të zgjidhnin një krim imagjinar duke përdorur qasjen IBL. Atyre iu paraqit një skenar i sajuar i krimit me përshkrimin e viktimës dhe të dyshuarve. Detyra e tyre ishte të analizonin provat e mbledhura duke kryer eksperimente të ndryshme të kombinuara me qasjen IBL dhe të zbulonin se kush nga të dyshuarit e ka kryer krimin. Punëtorja zgjati mesatarisht 4 orë shkollore (45 minuta secila) dhe përbëhej nga katër stacione pune që mbulonin fusha të ndryshme të shkencës mjeko-ligjore, të tilla si analiza e gjurmëve të gishtërinjve, analiza e substancave të panjohura, analiza e fibrave dhe elektroforeza e ADN-së (Figura 3).



Figura 3: Analiza e provave në "Laboratorin e Mjekësisë Ligjore".

Pjesëmarrësit (N = 136) ishin ndërmjet 13 dhe 15 vjeç dhe u mor pëlqimi pas informimit nga prindërit dhe kujdestarët e nxënësve. Në çdo stacion pune, nxënësit u pajisën me një fletë pune. Çdo fletë pune u dha atyre një problem mjekoligjor për të zgjidhur. Ata filluan duke përcaktuar pyetjet dhe hipotezat kërkimore, vazhduan me hartimin dhe kryerjen e eksperimenteve dhe përfunduan duke diskutuar rezultatet e marra dhe duke nxjerrë përfundimet e duhura. Ne zbuluam se shumica e nxënësve kishin vështirësi në zhvillimin e duhur të dizajnit të kërkimit dhe kryerjen e eksperimenteve në lidhje me stacionin e punës për analizën e substancave të panjohura.

Përsëritjet e para të seminarit u vlerësuan dhe na dhanë rezultate, në bazë të të cilave u bënë disa përshtatje (faza e dytë e projektit DiSSI).

Moduli i përshtatur DiSSI përfshin:

1. Karta me figura për nxënësit me aftësi më të ulëta gjuhësore për t'i ndihmuar ata të kryejnë eksperimente dhe
2. Përfshirjen e mësimit të bazuar në lojë për nxënësit që të motivohen nëse vijën nga mjedise të ndryshme etnike ose kulturore.

U përdor një enigmë e thjeshtë dhe, kur u rregullua saktë, zbuloi emrin e të dyshuarit që kishte kryer krimin e ndriçuar me dritën UV, nxënësit morën një pjesë të enigmës në çdo vend pune bazuar në rezultatet e analizës së provave (Figura 4).

1. Preverjanje elektrike prevednosti raztopin

Skica poskusa	Potek dela po stopnjah
	<ul style="list-style-type: none"> - V dve 50 ml, časi nalij približno 20 ml destilirane vode. - V prvo dodaj eno spatulo snovi A, v drugo pa eno spatulo snovi B. - Premešaj, da se snovi raztopita.
	<ul style="list-style-type: none"> - Pripravi aparaturo za preverjanje prevednosti pripravljenih raztopin. - En vodnik s krokodilčkom pripni na pozitivno stran baterije. - Drugi vodnik na enem delu s krokodilčkom pripni na negativno stran baterije, z drugim pa na krajšo žico diode. - Na daljšo žico diode s krokodilčkom pripni še preostali vodnik.
	<ul style="list-style-type: none"> - Preveri prevednost raztopin. - Pomoči nepovezana dela vodnikov v eno izmed raztopin. - Pazi, da se konici vodnikov pri tem ne dotakneta.
	<ul style="list-style-type: none"> - Preden vodnika pomočiš v drugo raztopino, ju speri z destilirano vodo.
	<ul style="list-style-type: none"> - Zapiši opažanja.

Figura 4: Përshtatjet e moduleve – udhëzime eksperimentesh për nxënësit që kanë vështirësi gjuhësore (majtas) dhe enigmë që zbulon emrin e të dyshuarit (Matej Prat) nën dritën UV (djathtas).

Tabela 1 tregon frekuencat absolute dhe relative të marrëveshjeve të nxënësve me artikujt e përzgjedhur që lidhen me interesin e situatës që përshkruan interesin e nxënësve për të marrë pjesë në mjediset arsimore joformale të ofruara nga modulet DiSSI. Nxënësit mund të vlerësojnë çdo artikull me shkallën Likert prej pesë pikësh me opsionet e pikëzimit nga pajtohem fuqimisht deri nuk pajtohem fare.

Tabela 1. Marrëveshja e nxënësve me artikujt e zgjedhur mbi interesin e situatës pas zbatimit të modulit (N = 136).

Artikulli		Pajtohem fuqimisht	Pajtohem	I pasigurt	Nuk pajtohem	Fuqimisht nuk pajtohem
Aktivitetet e sotme të kimisë ishin interesante.	<i>f</i>	71	60	4	0	1
	<i>f</i> %	52.2	44.1	2.9	0	0.8
*Sot e kuptova mirë atë që mësuam në aktivitetet e kimisë.	<i>f</i>	41	76	16	2	0
	<i>f</i> %	30.4	56.3	11.8	1.5	0
Dua të mësoj më shumë rreth përmbajtjes mësimore që trajtuam në aktivitetin e sotëm të kimisë.	<i>f</i>	17	43	54	20	2
	<i>f</i> %	12.5	31.6	39.7	14.7	1.5

* Nië vlerë mungonte.

Nga rezultatet e paraqitura në tabelën 1, mund të konkludohet se shumica e nxënësve (96,3 %) ishin të pajtimit ose ishin fuqimisht u pajtuan që aktiviteti i kimisë ishte interesant ose shumë interesant për ta. Një përqindje shumë e vogël e nxënësve (2,9 %) ishin të pasigurt për këtë artikull dhe vetëm një nxënës fare nuk pajtohej me këtë artikull. Një përqindje kaq e lartë e pajtueshmërisë me artikullin që aktiviteti i kimisë ishte interesant ose shumë interesant për nxënësit na tregon se tema e zgjedhur e aktivitetit të kimisë ishte aktuale dhe e lidhur ngushtë me përmbajtjen interesante për nxënësit. Rezultatet e pikës së dytë na tregojnë se shumica e nxënësve (86,7 %) e kanë kuptuar mirë përmbajtjen e diskutuar të aktivitetit kimik. Pak më shumë se 10% e nxënësve ishin të pasigurt për këtë pikë dhe vetëm 1.5% e nxënësve nuk ishin të pajtimit me këtë pikë. Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se udhëzimet për mënyrën e kryerjes së aktivitetit të kimisë ishin të kuptueshme për nxënësit. Mund të argumentohet gjithashtu se përshtatjet e prezantuara të modulit DiSSI patën një ndikim pozitiv në kuptimin e përmbajtjes së aktivitetit të kimisë, pasi ato e prezantuan përmbajtjen në mënyrë të thjeshtuar, e cila përfshinte udhëzime hap pas hapi me pamje vizuale. Bazuar në rezultatet e pikës së tretë, mund të konkludohet se më pak se gjysma e nxënësve (44,1 %) do të donin të dinin më shumë për përmbajtjen që diskutuan në aktivitetin e kimisë. Pak më pak se 40% e nxënësve nuk mund të angazhoheshin qartë për këtë artikull, ndërsa pjesa tjetër u përgjigj se nuk do të mësonin më shumë për përmbajtjen e diskutuar sepse kishin marrë të gjithë informacionin që dëshironin të merrnin duke marrë pjesë në këtë aktivitet të kimisë. Nga rezultatet, mund të supozohet se nxënësit të cilët dëshirojnë të mësojnë përmbajtjen në mënyrë më të detajuar janë gjithashtu shumë të interesuar të mësojnë më shumë rreth koncepteve të kimisë. Për nxënësit që nuk mund të përcaktojnë qartë marrëveshjen e tyre, mund të argumentohet se aktiviteti i kimisë ka nevojë për ndihmë shtesë nga mësuesin, të cilët mund të nxisin interesin e nxënësve për përmbajtjen që ofrojnë modulet DiSSI.

PËRFUNDIM

Gjetja më e dukshme që del nga ky studim është se përmbajtja e mësimdhënies dhe mësimnxënies së kimisë përtej standardeve të zakonshme të të nxënësve të kurrikulës kombëtare të kimisë për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta mund të zbatohet në mjedisin joformal të të mësuarit në universitet. Një mjedis i tillë i inkurajon nxënësit të mësojnë koncepte shtesë të kimisë, siç janë konceptet e shkencës mjeko-ligjore të cilat nxësin interesin për qasjet e të mësuarit të kimisë të bazuara në kërkime. Gjetja e dytë kryesore ishte se qasje të tilla janë gjithashtu të rëndësishme për zhvillimin e kompetencës kërkimore të nxënësve sipas mësimdhënësve që morën pjesë në punëtoritë e DiSSI. Si përfundim, projekti DiSSI në Slloveni ishte i suksesshëm.

MIRËNJOHJE

Puna e prezantuar ishte pjesë e projektit "DiSSI – Diversiteti në shkencë drejt përfshirjes sociale – edukimi joformal për diversitetin e nxënësve" që bashkëfinancohet nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, nën numrin e grantit 612103-EPP-1_2019 -1-DE-EPPKA3-IP1-SOC-IN. Dëshirojmë të falënderojmë Bashkimin Evropian për mbështetjen e tij financiare. Mbështetja e Komisionit Evropian për prodhimin e këtij publikimi nuk përbën miratim të përmbajtjes, e cila pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve, dhe Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për çfarëdo përdorimi të mundshëm të këtij informacioni.

REFERENCAT

Benny, N., and Blonder, R. (2018) 'Interactions of chemistry teachers with gifted students in a regular high-school chemistry classroom', *Chemistry Education Research and Practice*, 19(2), pp. 122–134.

Gilbert, J. K., and Newberry, M. (2007) 'The characteristics of the gifted and exceptionally able in science', in K. S. Taber (ed.) *Science Education for Gifted Learners*. Londër: Routledge, pp. 15–31.

Taber, K. S. (2010) 'Challenging gifted learners: general principles for science educators; and exemplification in the context of teaching chemistry', *Science Education International*, 21(1), pp. 5–30.

MENDËSIA GJITHËPËRFSHIRËSE

Vlera Jashari, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

HYRJE

Filozofia e të drejtave të njeriut dhe përkufizimi i të drejtës sociale për gjithëpërfshirjen sugjeron që shoqëria mund të ndalojë diskriminimin duke u fokusuar në arsimimin e të gjithë fëmijëve pa i ndarë në shkolla të veçanta (Avramidis & Norwich, 2002; Thomas & Loxley, 2007).

Një arsim i barabartë është ai që siguron që fëmijët të kenë mundësinë për të fituar përmes edukimit aftësitë bazë të nevojshme për punë produktive, pavarësisht nga sfondi i fëmijës, aftësive apo potencialit që ka. Edhe sistemi i arsimit në Kosovë në vitet e fundit është duke u munduar për të ofruar arsimim të barabartë për nxënësit nga familjet me të ardhura të ulëta dhe/ose grupet e marginalizuara, por nxënësit me nevoja të veçanta për arsye të ndryshme, ku një ndër to edhe vetëdijësimi i shoqërisë ka ndikuar që të mbetën më të neglizhuar.

Si një proces kompleks dhe i vazhdueshëm, ndërtimi i komuniteteve gjithëpërfshirëse që mbështesin diversitetin është diçka që duhet të merret parasysh nga të gjithë, veçanërisht nga nxënësit dhe mësimitdhënësit. Kjo ndonjëherë mund të kërkojë një ndryshim qëndrimi ose "mendësie".

Për ta bërë këtë, fillimisht mësimitdhënësit duhet të reflektojnë mbi reagimin e tyre ndaj diversitetit, të shqyrtojnë paragjykimet e tyre personale dhe të reflektojnë mbi atë që mund t'u duhet të bëjnë për të pasur një qasje më pozitive (National Alliance, n.d.). Gjithashtu, një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon në suksesin ose dështimin e ndërtimit të komuniteteve gjithëpërfshirëse varet edhe nga strategjitë që përdoren në klasë.

Ndikimi që kanë mësimitdhënësit vihet re veçanërisht kur nxënësit fillojnë të kuptojnë ndjenjën e vetvetes dhe identitetin e tyre, gjë që është e rëndësishme në ndërtimin e empatisë dhe mirëkuptimit ndaj të tjerëve. Për shkak të ndikimit që kanë në jetën e tyre, është e rëndësishme të eksplorojnë strategjitë dhe qasjet që si mësimitdhënësit mund të përdorin jo vetëm për të modeluar pranimin e diversitetit, por edhe për ta përcaktuar atë si një pikë të fortë, në mënyrë që të ndërtojnë një mendësi gjithëpërfshirëse të nxënësve, që do të jetë edhe një përfitim i përjetshëm i të gjithë komunitetit dhe më gjerë.

UDHËZIME PËR MËSIMDHËNËS PËR ZHVILLIMIN E NJË MENDËSIE GJITHËPËRFSHIRËSE NË NJË KLASË TË RREGULLT

Zhvillimi i mendësisë gjithëpërfshirëse kërkon kohë, angazhim dhe bashkëpunim të qëndrueshëm midis shkollave dhe familjeve. Ky proces u mundëson nxënësve të ndërtojnë marrëdhënie kuptimplota, të zbatojnë parimet e Dizajnit Universal për Mësim dhe të krijojnë një komunitet që vlerëson diversitetin. Përmes përqafimit të gjithëpërfshirjes, mësimitdhënësit ndihmojnë në formimin e individëve me aftësi, respekt dhe përgjegjësi sociale, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.

Ky udhëzues paraqet strategji praktike për të ndihmuar mësimitdhënësit të ndërtojnë një mendësi gjithëpërfshirëse në klasa të rregullta, duke u fokusuar në vlerën e diversitetit, drejtësisë dhe bashkëpunimit.

1. KUPTIMI I RËNDËSISË SË GJITHËPËRFSHIRJES

- Theksoni që ndryshimet në aftësi, kultura dhe prejardhje janë burime që pasurojnë mjedisin e të nxënit;
- Siguroni që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.

2. ZHVILLIMI I NJË MENDËSIE INKLUZIVE

- Reflektoni mbi paragjykimet dhe qendrimet personale për të siguruar një qasje të drejtë ndaj nxënësve;
- Krijoni një kulturë klase që vlerëson dhe mirëpret dallimet si mundësi për të mësuar;
- Inkurajoni një mendësi gjithëpërfshirëse duke nxitur idenë se sfidat dhe gabimet janë mundësi për rritje dhe zhvillim.

3. NDËRTIMI I MARRËDHËNIEVE DHE KOMUNITITIT

- Nxisni punën në grup midis nxënësve me aftësi të ndryshme për të ndërtuar miqësi dhe mirëkuptim;
- Bashkëpunoni me prindërit për të mbështetur tranzicionin e nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta dhe për të adresuar shqetësimet e tyre;
- Zhvilloni rregulla të klasës në bashkëpunim me nxënësit për të krijuar një ndjenjë përkatësie dhe përgjegjësie, metodë kjo e cila mbështetet edhe me disa studime ku konsiderojnë që përfshirja e të gjithë nxënësve në zhvillimin e rregullave në klasë u ofron atyre mundësinë për të bashkëpunuar dhe krijuar lidhje me njëri-tjetrin si dhe për të zhvilluar një ndjenjë përkatësie në klasë (Castle & Rogers, 1993; Martin & Hayes, 1998).

4. STRATEGJITË E MËSIMDHËNIES PËR GJITHËPËRFSHIRJE

- Zbatoni metoda fleksibile të mësimdhënies për t'iu përshtatur stileve dhe nevojave të ndryshme të nxënësve;
- Inkurajoni nxënësit të mësojnë nga njëri-tjetri përmes aktiviteteve grupore dhe mentorimit;
- Përshtatni materialet dhe metodat mësimore për të përmbushur nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve.
- Përfshini/ lexoni libra dhe tregime që reflektojnë perspektiva të ndryshme dhe nxisin empatinë.

5. KAPËRCIMI I SFIDAVE

- Dedikoni kohë për vetëvlerësim dhe zhvillim profesional për të përmirësuar praktikatat e mësimdhënies;
- Luftoni qëndrimet stereotipike duke theksuar potencialin dhe talentet e çdo nxënësi;
- Siguroni një tranzicion të lehtë për nxënësit me nevoja të veçanta duke adresuar aspektet sociale dhe emocionale, si dhe aspektet akademike.

6. MATJA E SUKSESIT

- Monitoroni pjesëmarrjen dhe ndërveprimin e nxënësve për të vlerësuar gjithëpërfshirjen në klasë;
- Merrni rregullisht mendime nga nxënësit, prindërit dhe kolegët për të identifikuar fushat për përmirësim;
- Vlerësoni dhe festoni sukseset në ndërtimin e një komuniteti të klasës gjithëpërfshirëse.



REFERENCAT

Avramidis, E., & Norwich, B. (2002). Teachers' attitudes towards integration / inclusion: a review of the literature. *European Journal of Special Needs Education*, 17(2), 129-147. <https://doi.org/10.1080/08856250210129056>

Castle, K., & Rogers, K. (1993). Rule-Creating in a Constructivist Classroom Community. 70(2), 77-80. <https://doi.org/10.1080/00094056.1993.10520997>

Martin, H., & Hayes, S. (1998). Overcoming Obstacles: Approaches to Dealing with Problem Pupils. *British Journal of Special Education*, 25(3), 135-139. 10.1111/1467-8527.00073

National Committee for Citizens in Education. (1994). A New Generation of Evidence: The Family is Critical to Student Achievement (A. T. Henderson & N. Berla, Eds.). National Committee for Citizens in Education.

Thomas, G., & Loxley, A. (2007). Deconstructing Special Education and Constructing Inclusion.

CILAT JANË RISITË ARSIMORE QË SYNOJNË SHKOLLAT ESTONEZE?

Kristi Klaasmägi, Prorektor i TLU për Inovacion Arsimor
Tiia Õun, Drejtoreshë e Shkollës së Shkencave të Arsimit të TLU-së
Kätlin Vanari, Shef i Qendrës TLU për Inovacion në Arsim

Gatishmëria e institucioneve arsimore për ndryshim dhe inovacion është drejtim i rëndësishëm i planit kombëtar të zhvillimit në arsimin estonez. Universiteti i Talinit ka vendosur mbështetjen për inovacionin arsimor në të gjitha nivelet nga kopshti deri në të mësuarit gjatë gjithë jetës si një nga qëllimet e tij. Në vitin 2019 kemi filluar me dhënien e çmimit të universitetit për Inovacion Arsimor, i cili ndihmon në nxjerrjen në pah të inovacionit që ndodh në institucionet arsimore – planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe të nxënësve të bazuar në fakte.

Në vitin 2022 kemi dhënë çmimin tashmë për herë të katërt dhe dhjetë risi arsimore u paraqitën në konkursin kombëtar. Në këtë konkurs njohim përmirësimet e institucioneve arsimore të cilat kanë katër karakteristika. Së pari, vlerësojmë se është inovacioni i nisur që synon mbështetjen e të mësuarit të nxënësve. Së dyti, e konsiderojmë të rëndësishme që iniciativa të ndikojë në kulturën e shkollës nga shumë aspekte, e të mos kufizohet në një aspekt të vetëm. Së treti, dëshirojmë të shohim përhapjen e inovacionit arsimor; është e rëndësishme që nisma të zbatohet në vetë

institucionin dhe të ngjall interes edhe jashtë institucionit. Së katërti, analizojmë pikëpamjen kritike të institucionit për aktivitetin e tyre aktual dhe planifikimin e përmirësimeve të mëtejshme. Këtë vit, çmimi u fitua nga shkolla Tartu Forselius për bashkëpunimin e mësimdhënësve në mbështetjen e nxënësve të vetëdrejtuar. Në vijim kemi sjellë shembuj të aktiviteteve praktike të inovacionit arsimor të fituesit të çmimit dhe institucioneve të tjera që ishin kandidatë. Shpresojmë që rastet e shkollave të Estonisë të frymëzojnë edhe institucionet arsimore në Kosovë.

INOVACIONI ARSIMOR MBËSHTET PROCESIN E MËSIMNXËNIES DHE ZHVILLIMIT TË NXËNËSIT

Shumica e institucioneve arsimore i drejtojnë risitë e tyre në mbështetjen e zhvillimit të nxënësve. Mësimdhënësit e shkollës Tartu Forselius, për shembull, kanë zhvilluar materiale që mbështesin nxënësve të vetëdrejtuar tashmë për katër vjet në rrethet e përbashkëta studimi, mësimdhënës të të gjitha niveleve të shkollës janë të përfshirë në proces. Fokusi ishte te nxënësi edhe në rastet e tjera. Për shembull, Shkolla e Mesme Pelgulinna ka mbështetur sistematikisht qarqet e studimit të

bashkëpunimin e tyre në mësimin e strategjive të të nxënësve për nxënësit. Kopshti Sipsik në Paldiski ka ndihmuar në formimin e aftësive të ardhshme të fëmijëve, të cilat lehtësojnë përbashkëpunimin e sfidave teknologjike duke krijuar një mjedis inovativ të të mësuarit.

Nisma e shkollës Tartu Forselius është e veçantë për faktin se për të mbështetur nxënësit e vetëdrejtuar, mësuesit nuk shpikin vetë mundësi në planifikimin e aktiviteteve, por ndjekin të dhënat e marra në studimin e nxënësve. Për shembull, vetëdrejtimi i nxënësve u hartua në bazë të MSLQ të Pintrich-ut në vitin shkollor 2019/2020. Rezultatet treguan se shënjestrimi i të nxënësve dhe gjithashtu përfshirja e nxënësve duhet të bëhet në mënyrë sistematike dhe në mënyrë të menduar mirë. Në vitin shkollor 2020/2021 është kryer testi i të nxënësve dhe vetëidentifikimit tek nxënësit e klasave 7 dhe 8 në bazën e të dhënave elektronike të Vlerësimit, dhe vetëdijesimi për strategjinë e të nxënësve për vitin 2021/2022 të të gjithë nxënësve në Shkollën Forselius u hartua nga pyetësi i tregimeve mësimore dhe përmes intervistave në fokus grup.

INOVACIONI ARSIMOR KA NDIKIM NË KULTURËN E SHKOLLËS NË TËRËSI

Një nga karakteristikat e aktivitetit të inovacionit është sistematika dhe ndikimi më i gjerë në kulturën e një institucioni në tërësi. Inovacioni arsimor i njohur karakterizohet nga sistematika në mbështetjen e nxënësve të vetëdrejtuar. Në shkollën Forselius materialet mësimore krijohen gjatë mësimit të përbashkët të mësuesit dhe nxënësve, ku në çdo klasë janë vendosur postera të krijuar bashkërisht nga stafi. Posterat pasqyrojnë qasjen e përbashkët të stafit mësues ndaj mësimit dhe të nxënësve.

Qëllimi i vendosur mbështetet edhe nga organizimi i mësimeve në shkollë me orë mësimore 85-minutëshe, është zhvilluar një strukturë specifike e mësimeve dhe një modul i mësimit të mësuesit të klasës.

Një sistematikë e ngjashme në trajtimin e aspekteve të ndryshme të jetës shkollore u paraqit edhe në rastin e nismave të tjera arsimore. Për shembull, inovacioni i Shkollës Bazë Uhtna u përqendrua në punëtoritë e vetë-zhvillimit që formësojnë kompetencat komunikuese të nxënësve.

Për organizimin e punëtorëve u ndryshuan oraret dhe u ofrua një kurs trajnimi përkatës për prindërit. Rruga e arsimit gjithëpërfshirës në kopshtin Loitsu ka përfshirë edhe mësimin e mësuesve në kuadër të kurseve të trajnimit dhe punës ekipore, bashkëpunimin më të ngushtë mes mësuesve dhe ekipit të koordinatorëve të studimeve për nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe përvetësimin e materialeve mësimore që plotësojnë mjedisin mësimor.

Këta janë shembuj të mirë se si qëndrueshmëria e një nisme varet nga shkalla në të cilën aktivitetet e ndryshme të jetës shkollore përqendrohen rreth qëllimit të përbashkët. Mesazhi për institucionet e tjera arsimore është: në organizimin e çdo ngjarjeje, është e rëndësishme të parashikohet qëllimi i ngjarjes së tyre dhe si të mbështetet ky ndikim në aktivitetet e tjera të jetës shkollore.

INOVACIONI ARSIMOR PËRHAPET

Shkolla Tartu Forselius ka prezantuar aktivitetet e saj në mbështetjen sistematike të nxënësve të vetëdrejtuar gjatë vizitave në shkollë si dhe për publikun e gjerë, p.sh. në seminarin në internet "Më i mençur në distancë: aftësitë e mësimnxënies dhe strategjitë në praktikë". Materiali udhëzues i krijuar nga mësimdhënëset e kopshtit Mondo Maailmakool dhe Rannamõisa Merike Niibek dhe Kersti Veskus janë përdorur në trajnimet e mësimdhënësve për edukimin e vazhdueshëm, janë shpërndarë në një grup në Facebook dhe janë prezantuar në shkollën verore të arsimit parashkollor. Shkolla e mesme Pelgulinna ka ndarë historitë e përvojave të mësimdhënësve të saj në gazetën e edukatorëve estonezë "Õpetajate Leht", në takimet e shoqatave të drejtuesve të shkollave rajonale dhe ndërkombëtarisht në rrjetin e shkollave.

INOVACIONI ARSIMOR SJELL ANALIZA

Në njohjen e aktiviteteve të inovacionit arsimor, dëshiroam që nga ana e universitetit të evidentojmë shembuj të tillë ku ka ndodhur inovacioni së bashku me një analizë. Është e rëndësishme të mblidhen informacione që mund të përdoren për planifikimin e aktiviteteve zhvillimore në zbatimin e ideve të reja. Do të ishte e dobishme nëse reagimet nga palët e lidhura drejtpërdrejt me inovacionin të mund të merren si bazë.

Merike Niibek dhe Kersti Veskus, për shembull, përdorën komentet e mësimdhënësve në përpilimin e materialit udhëzues për edukimin global. Si universitet, vlerësojmë shumë monitorimin e tillë të aktivitetit që bazohet në një model apo qasje teorike. Për shembull, kopshti Sipsik në Paldiski përdori testimin online bazuar në modelin DigiCompEdu për të vlerësuar kompetencat digjitale të mësimdhënësve. Shkolla e mesme Pelgulinna hartoi përdorimin e strategjive të të nxënësve të nxënësve me anë të një ankete brenda shkollës dhe pjesëmarrjes në studimin shkollor të TLU-së. Shkolla bazë Uhtna hartoi zhvillimin e kompetencave komunikuese dhe aftësive sociale me anë të testeve të komunikimit dhe vetëidentifikimit të zhvilluara nga studiuesit e TLU-së. vëzhguan aktivitete mësimore gjatë vizitave në shkollë.

Shkolla Tartu Forselius ka analizuar aktivitetet e saj me metoda të ndryshme, gjë që siguron pikënisje të besueshme për hapat e mëtejshëm. Në rastin e iniciativës së njohur, u krijuan reagime apo informata kthyesë një minutëshe për mësimdhënësit; rezultatet e tyre u diskutuan bashkërisht në rrethet e studimit, vetëdijesimi i nxënësve për strategjitë e të nxënësve u hartua nga një fokus grup dhe një mjet kërkimor shkencor dhe u vëzhguan aktivitete mësimore gjatë vizitave në shkollë.

INOVACIONI ARSIMOR SJELL ANALIZA

Shembulli 1.


Shkolla Tartu Forselius fitoi mirënjohje për risinë arsimore afatgjatë dhe sistematike që përfshin të gjithë mësimdhënësit dhe ka për qëllim zhvillimin e nxënësve. Shembuj të tjerë të iniciativave që u paraqitën në konkurs demonstrojnë gjithashtu mbështetje inovative dhe të bazuar në fakte për zhvillimin e nxënësve në shkollat dhe kopshtet estoneze.

Universiteti i Talinit do të vazhdojë garën e nismës së Inovacionit Arsimor edhe në vitin 2023 për të njohur institucionet arsimore dhe për të inkurajuar vetë-zhvillimin dhe mësimin e vazhdueshëm të të gjithë pedagogëve.

Shembuj të materialeve studimore të krijuara në shkollën Tartu Forselius për të mbështetur nxënësit me vetë iniciativë.



Shembulli 2.



T'I NJOHIM DHE PËRKRAHIM KOMPETENCAT SHKENCORE


Albulena Metaj & Arlinda Bytyqi- Damoni
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

Kompetenca shkencore, apo "aftësia për të menduar në mënyrë shkencore" i referohet kapacitetit për të kuptuar konceptet shkencore, fenomenet dhe proceset shkencore, si dhe për t'i zbatuar këto njohuri në situata të reja dhe në aspektet që na rrethojnë në jetën e përditshme dhe në botë.

Kompetencat shkencore në sytë e mësimdhënësve ndërlidhen me fokusin e të qenurit përkrahës për nxënësit; për t'i ndihmuar ata që të mësojnë shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve. Sipas Venville dhe Dawson (2012), ekzistojnë dy qasje lidhur me shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve:

1. Përkrahja e nxënësve – të ndihmuarit e nxënësve për t'i interpretuar ilustrimet shkencore;
2. Të ndërtuarit e sekuencave mësimore – nxënësit udhëhiqen nga mësimdhënësit "për të ndërtuar përfaqësimet e tyre shkencore" përmes praktikave jo-formale. Kjo praktikë bazohet në njohuritë e nxënësve përmes çdo mësimi që është mësuar dhe ndërlidhjen e këtyre përmbajtjeve me praktikatat e jetës së përditshme.


Venville and Dawson (2012) e përshkruajnë kompetencën shkencore të nxënësve në diagramin e mëposhtëm:



PRAKTIKAT E MËSIMDHËNIES NË SHKOLLAT E KOSOVËS SIPAS PERSPEKTIVËS SË NXËNËSVE - REZULTATET NGA TESTI PISA 2018

Fjolla Kaçaniku, Jeta Aliu & Arian Musliu
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

Kosova mori pjesë për herë të dytë në testin PISA në vitin 2018, me fokus në fushën e leximit. Nxënësit kanë qenë pjesë e administrimit të pyetësorit që synon të masë perceptimet e nxënësve lidhur me praktikat e mësimdhënies në klasën e tyre. Disa statistika rreth kësaj çështjeje janë paraqitur në përmbledhjen më poshtë.



PRAKTIKAT E MËSMDHËNIES NË SHKOLLAT E KOSOVËS SIPAS PERSPEKTIVËS SË NXËNËSVE - REZULTATET NGA TESTI PISA 2018

EKSPOZIMI I NXËNËSVE NDAJ PRAKTIKËS SË MËSIMDHËNIES SË BAZUAR NË INFORMATË KTHYESE (FEEDBACK)

Më shumë se 50% e nxënësve deklarojnë që mësimit ju ndihmojnë që të ndërlidhin mësimit me jetët e tyre.

83% e nxënësve kanë përshtypje që mësimit i bëjnë të ndihet me vetëbesim më të lartë për të treguar performancë më të mirë.

Gjysma e studentëve marrin feedback për aspektet e tyre të forta (përparësitë) dhe aspektet ku ata duhet përmisohen, gjersa gjysma tjetër jo.

40% e nxënësve deklarojnë që mësimit nuk i inkurajojnë ata të shprehin mendimet e tyre për një tekst.

EKSPOZIMI I NXËNËSVE NDAJ PRAKTIKËS SË MËSIMDHËNIES SË BAZUAR NË HULUMTIM

35% e nxënësve nuk kanë mësuar të hulumtojnë materialet mësimore në internet duke përdorur fjalë kyçe.

Një e treta e nxënësve nuk kanë mësuar të vlersojnë kredibilitetin e informatave në internet.

Rreth 40% e nxënësve nuk kanë mësuar të krahasojnë informatat prej burimeve të ndryshme të internetit dhe të vendosin për përdorimin e tyre.

PRAKTIKAT E MËSIMDHËNIES DHE REZULTATET E NXËNËSVE NË LEXIM NË PISA 2018

Nxënësit deklarojnë që më shumë janë të ekspozuar ndaj praktikave të mësimdhënies së individualizuar dhe të orientuar ndaj komenteve nga mësimdhënësit, sesa praktikave të mësimdhënies së bazuar në hulumtim, përderisa në testin PISA 2018, nxënësit që kanë deklaruar se mësimdhënësit e tyre e fasilitojnë të mësuarit përmes hulumtimit kanë treguar performancë më të mirë në fushën e leximit.

Në përgjithësi, nxënësit ndihen që përjetojnë praktika të mësimdhënies me nxënësin në qendër, që nënkupton se mësimdhënësit në shkollat e Kosovës implementojnë ndryshimet kurrikulare që kanë afektuar praktikatat e mësimdhënies.



PYETJE PËR REFLEKTIM!

1. Si mësimdhënës, cilat praktika të mësimdhënies i përdorni më shumë për të mbështetur të nxënësit e nxënësve?
2. Cilat nga praktikatat e përdorura kanë të bëjnë me mbështetjen e individualizuar ndaj nxënësve, ofrimin e komenteve për nxënësit, dhe mësimdhënien e bazuar në hulumtim?
3. Diskutoni me kolegë se si mund t'i mbështesni më së miri nxënësit përmes praktikave të mësimdhënies.

USHTRIME PRAKTIKE PËR TË NXITUR MENDIMIN KRITIK

Albulena Metaj & Arlinda Bytyqi- Damoni
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës

1. Bëni pyetje

Bërja e pyetjeve, veçanërisht pyetjeve të hapura, u jep nxënësve të shkollave fillore mundësi për të zbatuar atë që kanë mësuar dhe për të ndërtuar mbi njohuritë e mëparshme.

2. Brainstorming

Brainstorming (stuhi mendimesh) është një qasje jashtëzakonisht praktike edhe në arsimin fillor. Për më tepër, është gjithashtu mjet i shkëlqyer mësimor. Është një ushtrim i shkëlqyer i të menduarit kritik, veçanërisht kur shoqërohet me elemente vizuale që nxixin mendimin origjinal dhe diskutimet në klasë lidhur me tematika të ndryshme.

3. Inkurajoni vendimmarrjen

U mundëson nxënësve të zbatojnë njohuritë e mësuara në situata të ndryshme, nga këndvështrime të ndryshme, të vlerësojnë dhe argumentojnë avantazhet dhe disavantazhet e zgjidhjeve të ndryshme, më pas, në fund të vendosin se cilat ide funksionojnë më së miri.

7. Ndërlidhni idetë e ndryshme

Ndërlidhja e ideve të ndryshme është çelësi për të nxitur shkathhtësitë e mendimit kritik. Për shembull, mësimdhënësit e shkollave fillore mund t'i pyesin nxënësit nëse kanë ndonjë ide se përveç aspektit demografik, si mund të ndikojnë migrimet p.sh në ekonominë e vendit, në stilin/mënyrën e jetesës, në planifikimin e hapësirave publike, në aspektin socio-kulturor, etj.

4. Nxisni punën në grupe

Të nxënit bashkëpunues mundëson ekspozimin e studentëve ndaj proceseve të të menduarit të shokëve të klasës si dhe zgjerimin e të menduarit dhe botëkuptimit e tyre duke demonstruar se nuk ka asnjë mënyrë të drejtë për t'iu qasur një problemi.





6. Këndvështrime të ndryshme

Kjo qasje jo vetëm që përcakton se një ide duhet të vlerësohet nga këndvështrime të ndryshme përpara se të formohet një opinion, por u jep nxënësve një mundësi për të ndarë pikëpamjet e tyre ndërsa dëgjojnë dhe mësojnë nga të tjerët.

5. Nxisni kreativitetin

Kjo qasje jo vetëm që përcakton se një ide duhet të vlerësohet nga këndvështrime të ndryshme përpara se të formohet një opinion, por u jep nxënësve një mundësi për të ndarë pikëpamjet e tyre ndërsa dëgjojnë dhe mësojnë nga të tjerët.

LAJME
DHE 
NJOFTIME



INAUGUROHET LABORATORI MODERN 'EDUKIMI PËR STEAM' NË FAKULTETIN E EDUKIMIT

Ky laborator, i pari i këtij lloji për qëllime arsimore, synon përgatitjen e mësimeve të rinj për zhvillimin e kreativitetit në mësime përmes teknologjisë dhe integritit të lëndor, duke kaluar nga modelet tradicionale në ato krijuese.

I pajisur me robotikë, mikrokontrollues të riprogramueshëm, pajisje CNC, printer 3D, syze të mençura, pajisje EEG dhe teknologji të tjera moderne, laboratori përfaqëson një hap drejt modernizimit dhe përafritimit me standardet evropiane.

Studentët zhvillojnë shkathtësi për dizajnimin e aktiviteteve mësimore që nxisin mendimin kritik dhe integrimin e shkencës, teknologjisë, artit dhe matematikës (STEAM).

Përvoja në laborator i përgatit ata për të zbatuar mësime digjitale dhe inovative, të orientuar në nxënësin dhe forma atraktive.



MIRË SE VJEN NAO!

FEdu bën një avancim revolucionar në qasjen tonë ndaj arsimit përmes teknologjisë. Një mirësearchje speciale për NAO FEduBot 🤖, robotin tonë të parë humanoid, në atë që është padyshim hapësira më inovative arsimore në vend dhe përtej!

NAO është programuar për të facilituar mësimdhënien, për ta avancuar praktikën dhe për të lehtësuar të nxënit.

Aktualisht, po zbatohet intervenimi me Robotin NAO për të lehtësuar të nxënit për fëmijët me nevoja të veçanta.

LANSOHET PROJEKTI #VALUED EDUKIMI I BAZUAR NË VLERA PËRMES REFORMIMIT TË POLITIKAVE DHE PRAKTIKAVE TË MËSIMDHËNIES

Përmes këtij projekti strukturor - i pari i këtij lloji në Kosovë që financohet nga **European Commission** FEdu synon të transformojë programet për përgatitjen e mësimdhënësve duke përfshirë e reflektuar më mirë vlerat si barazia, mos-diskriminimi, edukimi qytetar dhe gjithëpërfshirja në të gjitha nivelet e arsimit.

Në katër vitet e ardhshme, Fakulteti do të punojë të:

- zhvillojë politika dhe korniza kombëtare për përgatitjen e mësuesve që përfshijnë edukimin gjithëpërfshirës dhe qytetarinë demokratike.
- përmirësojë dhe reformojë programet e përgatitjes së mësimdhënësve për të përfshirë metodologji të bazuar në vlera
- forcojë komponenten e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke ofruar trajnime për të mësuar barazi, diversitet dhe qytetari përgjegjëse, dhe
- mbështesë praktikën shkollore me qëllim të zhvillimit të kompetencës së qytetarisë së përgjegjshme përmes Intervenimeve direkte në shkolla për zhvillimin e një kulture dhe klime shkollore demokratike dhe gjithëpërfshirëse.




REFORMË E ZBATIMIT TË KOMPETENCËS ICT NË PROGRAMET E STUDIMIT

TKAEDITE.eu është projekt i financuar nga BE, dhe koordinuar nga FEdu që synon transformimin e sistemit arsimor në Kosovë dhe Shqipëri për t'u përshtatur me sfidat digjitale. Projekti promovon inovacionin dhe integrimin e teknologjive moderne në arsimin parauniversitar dhe universitar, duke përfshirë:

- Krijimin e programit EdTech në Fakultetin e Edukimit për përgatitjen e mësimeve në transformimin digjital të shkollave.
- Promovimin e STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë).
- Rritjen e kompetencave digjitale të edukatorëve dhe hartimin e kornizës për avancimin e kompetencave digjitale të mësimeve, me bazë në kornizën DigCompEdu .
- Reformimin e kurrikulës parauniversitare në lëndët e TIK-së.
- Krijimin e një studioje regjistrimi në Universitetin e Prishtinës.
- Hartimin e një Plani Veprimi për Rritjen e Kompetencave Digjitale të Edukatorëve me Teknologjitë më të Avancuara si Inteligenca Artificiale (AI), Realiteti Virtual (VR), Realiteti i Shtuar (AR), dhe mjetet e tjera inovative.

Koordinuar nga Fakulteti i Edukimit – UP, partnerët ndërkombëtarë nga Finlanda, Suedia dhe Norvegjia sjellin ekspertizë në transferimin e teknologjive dhe njohurive.



NIS HARTIMI I PROGRAMIT TE RI BACHELOR

Fakulteti ka nisur hartimin e programit inovativ BA për Edukim që fillimisht do të ketë dy specializime:

- Teknologjia arsimore - një profil i ri që do të mbështesë digjitalizimin e proceseve mësimore në sistemin shkollor;
- Edukim gjithëpërfshirës një profil që synon përgatitjen e mësimeve për të promovuar barazinë dhe përfshirjen në sistemin arsimor.

Programi i ri synon të plotësojë zbrastësirat në përgatitjen e kuadrove të reja dhe rritjen e kontributit të fakultetit në ngritjen e kapacitetit të sistemit të arsimit në procesimin e praktikave e trendeve inovative në këto dy fusha me interes.

**FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

EduForum

REVISTA PËR MËSIMDHËNËS